



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 851/10 prot

Datë 11.06.2024

V E N D I M
Nr.668/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.06.2024 me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshuar*”, me Nr. REF-92495-12-29-2023, me objekt: “Blerje veshje të ndryshme pune për UKT SH.A”, me fond limit 9,999,829.00 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 31.01.2024, nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujësjiellës Kanalizime Tiranë.

Shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorin ekonomik “Blerina Sadiku” PF në procedurën e prokurimit të sipërpërmendur.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Malbertex” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërpërmendur.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Malbertex” SHPK, me NIPT (K71821009N), me adresë: Rruga “Siri Kodra”, blloku magazinave, Tiranë.

Operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF, me NIPT (L12330004A), me adresë Bulevardi “Gjergj Fishta”, kulla nr. 2, kati i dytë, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: SH.A Ujësjiellës Kanalizime, Tiranë, me adresë: Rruga e Kavajës, Ndërtesa nr.133, Njësia Administrative 6,Kodi Postar 1027,Tiranë.

Subjekte të Interesuar: Operatori ekonomik “Blerina Sadiku” pf, me NIPT K97730102T, me adresë KUCOVE, Perondi Berat Perondi, MAGJATE, Godinë 1 katëshe në Magjatë pranë ish-uzinës së aviacionit.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 05.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues, kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03-01-2024, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshuar*”, me Nr. REF-92495-12-29-2023, me objekt: Blerje veshje të ndryshme pune për UKT sh.a”, me fond limit 9,999,829.00 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 31.01.2024, nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujësjiellës Kanalizime Tiranë.

II.2. Në datën 31.01.2024, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi.

II.3. Në datën 19.03.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Blerina Sadiku P.F	8.929.300 lekë	skualifikuar
2. “Vojsava Zenelaj” P.F	9.511.400 lekë	kualifikuar
3. “Malbertex” SHPK	9,577,040 lekë	kualifikuar

II.3. Në datën 03.04.2024, është Publikuar Njoftim - Fituesi i procedurës së prokurimit objekt-ankimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

II.4. Në datën 08.04.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/3939, si dhe nr. protokollit 828/2024, datë 08.04.2024, i operatorit ekonomik “Malbertex” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF, si dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Blerina Sadiku” Pf.

II.5. Në përputhje me nenin 112, “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 828/2 prot., datë 08.04.2024, janë publikuar pretendimet dhe kriteret e kualifikimit për të cilat ankimuesi “*Malbertex*” SHPK, në ankesën me nr. 828 prot., datë 08.04.2024, pretendon, se nuk përmbushen nga operatori ekonomik pjesëmarrës “*Vojsava Zenelaj*” PF, si dhe pretendimet dhe kriteret e kualifikimit për

të cilat ankimuesi ngre pretendime, se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Blerina Sadiku” pf.

II.6 Në datën 09.04.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. protokollit 851/2024, datë 09.04.2024, e operatorit ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF, për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Malbertex” SHPK.

II.7. Në përputhje me nenin 112, “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 851/2 prot., datë 11.04.2024, janë publikuar pretendimet dhe kriteret e kualifikimit për të cilat ngre ankimuesi “Vojsava Zenelaj” PF, në ankesën me nr. 851 prot., datë 09.04.2024, se nuk përmbushen nga operatori ekonomik pjesëmarrës “Malbertex” SHPK.

II.6. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, u konstatua, se më datë 11.04.2024, operatori ekonomik i interesuar “Vojsava Zenelaj” PF, ka paraqitur argumentimet në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Malbertex” SHPK, sipas parashikimeve në nenin 113, ligji Nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”.

II.7. Me shkresën nr. 18954/19 prot, datë 17.04.2024, me objekt: “Informacion mbi trajtimin e ankesës së shoqërisë “Malbertex” SHPK protokolluar me tonën me nr. 828/4 prot. datë 19.04.2024, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor mbi procedurën e prokurimit objekt – shqyrtimi, si dhe akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Malbertex” SHPK, nga verifikimi i të cilit rezulton, se ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Malbertex” SHPK.

II.8. Me shkresën nr. 18954/22 prot, datë 17.04.2024, me objekt: “Informacion mbi trajtimin e ankesës të shoqërisë “Vojsava Zenelaj” PF”, protokolluar me tonën me nr. 851/3 prot. datë 19.04.2024, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor mbi procedurën e prokurimit objekt – shqyrtimi, si dhe akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF nga verifikimi i të cilit rezulton, se ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Vojsava Zenelaj” PF.

II.9 Me shkresën me nr. 851/4 prot., datë 06.06.2024, me lëndë “Kërkesë për paraqitje provash”, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor SH.A Ujësjellës Kanalizime, Tiranë, paraqitjen e dokumentacionit provues dhe/ose fotokopje të librit të protokollit që vërteton datën e protokollimit të ankesës pranë autoritetit kontraktor.

II.10 Me shkresën me nr. 851/5 prot., datë 06.06.2024, me lëndë “Kërkesë për paraqitje provash”, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar operatorit ekonomik Vojsava Zenelaj PF paraqitjen e dokumentacionit provues, që vërteton datën e e protokollimit të ankesës pranë autoritetit kontraktor.

II.11 Me shkresën datë 10.06.2024, me lëndë, “Për dorëzim dokumentacioni në funksion të shqyrtimit të ankesës së paraqitur në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje veshje të ndryshme pune për UKT SH.A, me REF-92495-12-29-2023”, protokolluar me tonën me nr. 851/6 prot., datë 10.06.2024, operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF ka dorëzuar dokumentin e lëshuar nga posta ADE, që vërteton datën e dorëzimit të ankesës.

Referuar shkresës së sipërcituar, rezulton që operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF, ka dorëzuar ankesën në datë 09.04.2024, në postën Adex, ku nga gjurmimi nëpërmjet kodit POD rezulton: “*Porosia është dorëzuar në datë 09.04.2024 ora 2:40:47 PM*”.

II.12 Nëpërmjet shkresës me nr. K-1486/1 prot., datë 10.06.2024 (dërguar në adresën e postës elektronike kpp_info@kpp.gov.al), protokolluar me tonën me nr. 851/7 prot., datë 11.06.2024 me lëndë “Kthim - përgjigje”, autoriteti kontraktor informon si vijon: “*....Bashkëlidhur do të gjeni: 1. Formularin e ankesës nga operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF, me shkresë hyrëse me nr. K-887 prot., datë 11.04.2024*

2. Fotokopje të njehsuar të faqes së librit të protokollit për ankesën e sipërcituar.

3. E-mail-in e datës 06.06.2024 nga AK ku ju citohen të dhënat e kërkuara.”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Malbertex” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF me arsyetimin se: “*Lidhur me vlerësimin e KVO-së për përmbushjen e kriterit kualifikues të pikës 2.4 të shtojcës 7 të DST-ve duke e kualifikuar konkurrentin Vojsava Zenelaj PF kemi bindjen se anëtarët e KVO-së nuk e kanë kuptuar këtë kriter dhe janë mjaftuar vetëm me konstatimet se ky konkurent ka dorëzuar raporte testimi, duke e kualifikuar, por lidhur me këtë kriter ne pretendojmë se ky konkurent nuk e plotëson për arsyet e mëposhtme: Dëshmia e testimi zyrtar ose raport i testimi i paraqitur nga ky konkurent për artikullin pantallona pune nuk vërteton përmbushjen e standartit ISO 13688 ose ekuivalent, pasi dëshmia e testimi zyrtar ose raporti i testimi nuk është lëshuar për kompaninë prodhuese dhe për emërtimin e produktit dhe për kodin e*

produktit të deklaruar nga ana e këtij konkurenti në ofertën teknike. Gjithashtu dëshmia e testimi zyrtar ose raporti i testimi i paraqitur nga ky konkurent për artikullin pantallona pune përse i përket përmbushjes së standardit ISO 13688 ose ekuivalent nuk është lëshuar nga laboratorë i akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, pasi laboratorit që e ka lëshuar nuk është i akredituar për të kryer analizë lidhur me përmbushjen e standartit ISO 13688 ose ekuivalent...”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1 Në shtojcën nr. 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” në pikën 2.4 “Kapaciteti Teknik” në dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë

2.4.Dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare (raporte testi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta).Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti EN ose ekuivalente duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara me rregulloren EU nr 425/2016, ose ekuivalente.

III.1.2 Në shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë:

*Ne kriteret e vecanta te kualifikimit perkatesisht ne piken 2.4 eshte kerkuar si me poshte vijon:
Ishte :*

2.4.Dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare (raporte testi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta).Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti EN ose ekuivalente duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara me rregulloren EU nr 425/2016, ose ekuivalente.

Behet:

2.4.Dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare (raporte testi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta).Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti EN ose ekuivalente duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara sipas rregulloreve EU nr 425/2016, ose ekuivalente.

III.1.3 Në shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit, shtojca 5 "Specifikimet teknike", është modifikuar si më poshtë vijon:

Ne specifikimet teknike janë kërkuar si më poshtë vijon:

Ishte :

1. Përshkrimi i kërkesave Pantallona Pune

Pantallonat e punës duhet të jenë të perbera nga jo më shumë se 70% poliester dhe jo më pak se 30% pambuk. Materiali duhet të jetë i tillë që mos të krijojë rrudha dhe tkurrje. Duhet të sigurohet rehati maksimale dhe performanca e lartë. Për të krijuar lehtësi në punë, pantallonat duhet të jenë të pajisura me të pakten 6 xhepa të ndryshëm. Dy prej xhepave duhet të jenë të medhenj dhe duhet të jenë të pozicionuar të pjesa anësore e këmbeve, duhet të jenë me mbyllje me "Velcro" ose ekuivalente. Dy prej xhepave duhet të jenë në pjesën e pasme dhe dy të tjera duhet të jenë në pjesën e përparme. Pantallonat duhet të jenë me qepje të forcuar dhe me forçim ekstra në pjesët e dobëta në mënyrë të tillë që të kalojnë veshëtirësitë e krijuara nga ambienti i punës. Faktori i mbrojtjes të rrezeve ultravjollce duhet të jetë të pakten 40+ dhe duhet të sigurohet një bllokim i rrezeve jo më pak se 97%. Pantallonat duhet të jenë të pajisura me zinxhir në pjesën e përparme dhe shtrengimi të pjesa e belit duhet të mundësohet nga një kopse. Pantallonat duhet të jenë të modeluara në përputhje me standardin BS 22526-1 ose ekuivalent. Ngjyra e pantallonave duhet të jetë blu e erret.

2. Cizme llastiku

Cizmet duhet të ofrojnë siguri dhe komfort gjatë punimit, duhet të jenë kompozim i materialit PVC. Cizmja duhet të jetë e ndërtuar në mënyrë të tillë që t'i rezistojë ambienteve në kantieret e ndërtimit dhe të ofrojë siguri nga rënia e objekteve të ndryshëm. Sholla e cizmeve duhet të jetë ergonomike dhe duhet të ketë kaluar kushtet e testimit të antireshkitjes në pllaka qeramike dhe kushtet e testimit të antireshkitjes në sipërfaqe me vaj dhe sipërfaqe metalike, duhet të jetë rezistente ndaj hidrokarbureve, tretësirave të ndryshme dhe përmbajtjeve acide. Cizmja duhet të jetë e pajisur me shtrese metalike në pjesën e majes dhe me shtrese mbrojtëse në pjesën e kyceve, ndërsa sholla duhet të jetë celik kundër shpimit. Gjatesia e cizmes duhet të jetë të pakten 36 cm dhe nuk duhet të jetë më shumë se 2.5 kg në mënyrë që mos të krijojë veshëtirësi për operatorin gjatë punimit. Cizmja duhet të jetë anti-statike në mënyrë që të ofrojë mbrojtje nga kontakti elektrik. Cdo parameter i cizmes duhet të jetë në përputhje me standardin ISO 20345 ose ekuivalent.

3. Kepuce pune

Kepucet e punës duhet të jenë të ndërtuara me lekure dhe nuk duhet të fusin ujë. Klasa e sigurisë së kepuces nuk duhet të jetë më pak se klasa S3. Kepuca duhet të durojë goditje të mëdha me një madhësi jo më pak se 1980 J. Maja e kepuces duhet të jetë e pajisur me mbrojtje të forcuar celiku dhe sholla e poshtme duhet të jetë me celik dhe duhet të jetë rezistente ndaj shpimit. Goma e poshtme e kepuces duhet të jetë e modeluar në mënyrë të tillë që të jetë kundër rreshkitjes ndaj vajrave dhe karburanteve të ndryshme. Pjesa e thembres duhet të jetë me amortizim dhe duhet të përthithë energjinë e ecjes. Kepuca duhet të jetë antistatike në mënyrë

te tille qe te krijoje siguri te plote te operatori. Modelimi I kepuces duhet te jete ne perputhje me standardin ISO 20345 S3, ISO 20345 SRC ose ekuivalent.

4. Jelek fosforeshent

Jeleku duhet te jete me thurrje te perdhredhura dhe materiali duhet te jete 100% poliester. Jeleku duhet te kete aftesi dukshmerie shume te larta, duhet te kete ngjyre portokalli ne perputhje me standardin ISO 20471 ose ekuivalent. Jeleku duhet te jete I lehte ne menyre te tille qe mos te krijoje pengesa gjate punimit, mbyllja duhet te behet me ane te materialit “Velcro” ose ekuivalent dhe duhet te jete I certifikuar per te rezistuar mbi 45 larje. Jeleku nuk duhet te kete me pak se dy shirita reflektues vertikal dhe dy shirita reflektues horizontal ne menyre te tille qe te sigurohet dukshmeri e plote. Prerja e jelekut duhet te jete e tille qe te siguroje nje komfort total te operatorit. Jeleku duhet te kete te stampuar ne anen e majte stemen e “Ujesjelles Kanalizime Tirane UKT sh.a” dhe gjithashtu ne gjithe pjesen e pasme te tij. Jeleku duhet te jete I modeluar ne perputhje me standardet ISEA 107 R 2; ISEA 107 P 2; NZS 4602.1 D/N; NZS 1906.4 ose ekuivalent te tyre.

5. Xhupa me logo UKT

Xhupi duhet te jete I ndertuar ne menyre te tille qe te siguroje mbrojtje te plote nga te gjitha kushtet e motit. Duhet te jete me material 100% poliester dhe duhet te kete nje shtrese PVC per mbrojtje te plote. Xhupi duhet te kete aftesi te parandalimit te futjes se ujit dhe duhet te kete nje shtrese leshi ose ekuivalente per te krijuar komfort dhe ngrohtesi ne kushte te veshtira klimaterike. Menget e xhupit duhet te jene te rregullueshme te pjesa e kycit dhe duhet te jene te pajisura me shtrengues “Velcro” ose ekuivalent per te krijuar nje izolim perfekt. Xhupi duhet te kete xhep per telefonin, xhep te brendshem ne pjesen e kraharorit dhe 4 xhepa te jashtem per depozitim te sendeve te ndryshme. Mbyllja e xhupit duhet te behet ne pjesen e perparme me zinxhir dhe me nje kapak shtese per mbrojtje ndaj kushteve atmosferike. Qepja e xhupit duhet te jete hermetike per te krijuar nje mbrojtje me te madhe ndersa pjesa e belit duhet te jete elastike per te krijuar nje pershtatje te rehatshme dhe te sigurt. Xhupi duhet te kete te stampuar ne anen e majte stemen e “Ujesjelles Kanalizime Tirane UKT sh.a”

6. Bluze me munge te shkurtra pune me logo UKT

Bluza duhet te jete e modeluar me material poliester, jo me shume se 70% dhe me material pambuku jo me pak se 30%, menget duhet ti kete te shkurtra. Bluza duhet te jete e rehatshme dhe e ndertuar me thurrje “Marcella” ose ekuivalente. Qepja e bluzes duhet te jete e dyfishte per te siguruar rezistence me te madhe dhe faktori I mbrojtjes ndaj rrezeve ultravjollce nuk duhet te jete me pak se 40+, duhet te sigurohet nje bllokim I rrezeve te pakten 97%. Bluza duhet te jete me te pakten 3 kopsa dhe me jake te kthyer. Menget nuk duhet te jene me te shkurtra se 22 cm dhe nuk duhet te jene me te gjata se 27 cm. Gjatesia e bluzes nuk duhet te jete me shume se 82 cm, ne varesi te madhesis se ofruar. Madhesia e ofruar duhet te jete nga XS deri ne 5XL. Ngjyra e bluzes duhet te jete blu e erret. Ne anen e majte te pjeses se perparme duhet te jete e stampuar stema “Ujesjelles Kanalizime Tirane UKT sh.a”.

7. Bluze me munge te gjata me logo UKT.

Bluza duhet te jete me munge te gjata dhe duhet te jete kombinim I materialit poliester dhe pambuk, jo me shume se 70% poliester dhe jo me pak se 30% pambuk. Bluza duhet te krijoje

rehati gjate punimit. Thurrja e bluzes duhet te jete "Marcella" ose ekuivalent dhe qepja duhet te jete e dyfishte per te ofruar rezistence me te madhe. Jaka duhet te jete e kthyer dhe mbyllja duhet te jete me te pakten 3 kopsa. Faktori I mbrojtjes ndaj rrezeve ultravjollce nuk duhet te jete me pak se 40+, duhet te sigurohet nje bllokim I rrezeve te pakten 97%. Menget e bluzes nuk duhet te jene me pak se 62 cm dhe jo me shume se 70 cm, ndersa gjatesia e bluzes duhet te jete midis diapazonit 75 – 79cm, ne varesi te madhesis (S, M, L). Bluza duhet te kete madhesi te ndryshme, duke filluar nga XS dhe deri te 4XL. Ne anen e majte te pjeses se perparme duhet te jete e stampuar stema "Ujesjelles Kanalizime Tirane UKT sh.a".

8. Kominoshe pune kundra ujit.

Kominoshet duhet te ofrojne mbrojtje te plote ne cdo suate te veshtire atmosferike, duhet te jene material poliester 100% dhe duhet te jene te veshura me nje shtrese PVC. Seti duhet te perfshije pjesen e poshtme te pantallonave dhe pjesen e sipërme ne forme xhakete. Xhaketa duhet te jete me te pakten dy xhepa ne pjesen e perparme, nje kapuc dhe me mundesi per ajrosje dhe ventilim ne pjesen e pasme. Ne pjesen e perparme duhet te jete e pajisur me zinxhir ne menyre qe te krijoje lehtesi gjate veshjes. Menget e xhaketes duhet te jene ne pjesen e brendshme pjese elastike ne menyre qe te jete e izoluar plotesisht nga penetrimi I ujit. Pantallonat duhet te jene te pajisura me jo me pak se dy xhepa ne pjesen anesore te kembeve dhe duhet te jene pjesen e belit plotesisht elastike per te krijuar lehtesi per t'u veshur dhe komoditet gjate punimit. Qepjet e xhaketes dhe te pantallonave duhet te jene te izoluar per te ndaluar futjen e ujit. Kominoshet duhet te jene te prodhuara ne perputhje te plote me standardin ISO 24232 ose ekuivalent. Gjatesia e pantallonave duhet te jete midis diapazonit 106 – 115 cm ndersa gjatesia e xhaketes duhet te jete jo me pak se 74 cm dhe jo me shume se 85 cm. Masat e setit duhet te ofrohen nga madhesia S deri ne XXXL.

9. Doreza Pune

Dorezat e punes duhet te jene elastike dhe me material poliester, duhet te ofrojne mbrojtje te plote te duarve. Pjesa e pellembes duhet te jete e veshur me shtresen nitrile ose ekuivalente ne menyre te tille qe te krijohet rezistence ndaj gerryerjes. Dorezat duhet te jene peshe te lehte dhe nuk duhet te krijojne veshtiresi gjate punimit dhe duhet te jene pa qepje. Materiali I dorezes nuk duhet te krijoje pushitje dhe duhet te siguroje ajrosje perfekte. Doreza duhet te kete te pakten 2 thurrje per 1 cm² ne menyre qe te garantohet rehati maksimale. Cdo parameter I dorezes duhet te jete ne perputhje me standardin EN 420 ose ekuivalent dhe standardin EN 388 ose ekuivalent. Doreza duhet te ofrojne siguri kundrejt prerjes ne parametrat midis 200 g deri ne 498 g te ngarkeses se prerjes ne perputhje me standardin ISEA 105 ose ekuivalent.

10. Mushama shiu

Mushamaja duhet te jete me material poliester 100% dhe duhet te kete nje veshje PVC per ndalimin e depertimit te ujit. Menget duhet te jene elastike ne pjesen e brendshme dhe gjatesia e tyre duhet te jete te pakten 81 – 88 cm, ne varesi te mases. Mushamaja duhet te kete vrime nga pas per ajrosje dhe ventilim te vazhdueshem. Mbyllja e mushamase duhet te behet me nje zinxhir ne pjesen e perparme dhe qepja duhet te jete e izoluar me ngjites per te krijuar nje mbrojtje me te madhe. Mushamaja duhet te jete e pajisur me nje kapuc I cili mund te fshihet nen jake. Gjithashtu mushamaja duhet te jete e pajisur me te pakten dy xhepa per te vendosur

sende te ndryshme gjate operimit. Faktori I mbrojtjes ndaj rrezeve ultravjollce nuk duhet te jete me pak se 40+, duhet te sigurohet nje bllokim I rrezeve te pakten 97%. Cdo parameter I mushamase duhet te jete sipas standardit EN 343 ose ekuivalent. Mushamaja duhet te ofrohet ne madhesi S deri ne 4XL.

11. Mbrojtese koke e pajisur me ndricues LED.

Mbrojtjesja e kokes duhet te kete te instaluar ne trup nje drite te levizshme per te krijuar nje ambient te ndricuar ne kantiere pune te erreta. Materiali I jashtem i mbrojteses duhet te jete pambuk. Drita LED duhet te jete te pakten me tre modalitete ndricimi, nje modalitet per ndricim te ulet, nje modalitet per ndricim te larte dhe nje modalitet per ndricim pulsues. Ndricimi duhet te jete te pakten 145 lm dhe koha e operimit nuk duhet te jete me pak se 100 min per ndricim te larte dhe jo me pak se 220 min per ndricim te ulet. Bateria e ndricuesit duhet te jete Li-ION, e rikarikueshme dhe karikimi duhet te behet me ane te nje porte USB. Pjesa e brendshme e mbrojteses duhet te jete me material ABS ose ekuivalent ne menyre qe te kryeje zbutjen e goditjeve. Mbrojtjesja duhet te jete e pajisur me nje strehe jo me te shkurter se 2.5 cm ne menyre qe te siguroje fushepamje te gjere. Mbrojtjesja e kokes duhet te jete ne perputhje me rregulloren e Bashkimit European 2016/425 dhe duhet te kete markimin CE.

12. Xhakete per punime ne kushte ekstreme

Xhaketa duhet te jete e perbere nga material 100% poliester dhe pjeset anesore duhet te jene elastike per te ofruar lehtësi ne levizje. Pjesa e brendshme duhet te jete e pajisur me perberje leshi per te rritur nivelin e rehatise dhe nxehtesise. Xhaketa duhet te kete 3 nivele te ndryshme ngrohjeje: nivel te ulet, nivel mesatar dhe nivel te larte, dhe nivelet duhet te komandohen nga nje buton I cili duhet te jete ne pjesen e jashtme te xhaketes. Shperndarja e nxehtesise duhet te behet ne te pakten 3 siperfaqe te ndryshme te trupit: ne pjesen e pasme, ne pjesen e gjoksit dhe ne te dy xhepat anesor. Xhaketa duhet te kete te pakten kater xhepa funksional dhe nje xhep ekstra per vendosjen e burimit te ushqimit. Madhesite e xhaketes duhet te mundesohen nga masa S deri ne masen XXXL. Burimi I ushqimit duhet te jete te pakten 18V, jo me pak se 5.8Ah, e tipit Li-Ion dhe duhet te siguroje te pakten 34 ore punim ne nivelin e ulet te ngrohjes. Koha e plote e karikimit nuk duhet te jete me shume se 60 min. Burimi I ushqimit duhet te jete I pajisur me nje tregues LED te nivelit te baterise I cili duhet te sinjalizojë operatorin per nivelin e burimit te ushqimit e të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Behet:

1. Pantallona Pune

Pantallonat e punes duhet te jene te perbera nga jo me shume se 70% poliester dhe jo me pak se 30% pambuk. Materiali duhet te jete I tille qe mos te krijojë rrudha dhe tkurrje. Duhet te sigurohet rehati maksimale dhe performance e larte. Per te krijuar lehtësi ne pune, pantallonat duhet te jene te pajisura me te pakten 6 xhepa te ndryshem. Dy prej xhepave duhet te jene te medhenj dhe duhet te jene te pozicionuar te pjesa anesore e kembeve, duhet te jene me mbyllje me "Velcro" ose ekuivalente. Dy prej xhepave duhet te jene ne pjesen e pasme dhe dy te tjere

duhet te jene ne pjesen e perparme. Pantallonat duhet te jene me qepje te perforcuar dhe me perforcim ekstra ne pjeset e dobeta ne menyre te tille qe te kalojne veshtiresite e krijuara nga ambienti I punes. Faktori I mbrojtjes te rrezeve ultravjollce duhet te jete te pakten 40+ dhe duhet te sigurohet nje bllokim I rrezeve jo me pak se 97%. Pantallonat duhet te jene te pajisura me zinxhir ne pjesen e perparme dhe shtrengimi te pjesa e belit duhet te mundesohet nga nje kopse. Pantallonat duhet te jene te modeluara ne perputhje me standardin ISO 13688 ose ekuivalent. Ngjyra e pantallonave duhet te jete blu e erret.

2. Cizme llastiku

Cizmet duhet te ofrojne siguri dhe komfort gjate punimit, duhet te jene kompozim I materialit PVC. Cizmja duhet te jete e ndertuar ne menyre te tille qe t'I rezistojte ambienteve ne kantieret e ndertimit dhe te ofroje siguri nga renia e objekteve te ndryshem. Sholla e cizmeve duhet te jete ergonomike dhe duhet te kete kaluar kushtet e testimit te antireshkitjes ne pllaka qeramike dhe kushtet e testimit te antireshkitjes ne sipërfaqe me vaj dhe sipërfaqe metalike, duhet te jete rezistente ndaj hidrokarbureve, tretesirave te ndryshme dhe permbajtjeve acide. Cizmja duhet te jete e pajisur me shtrese metaliku ne pjesen e majes dhe me shtrese mbrojtese ne pjesen e kyceve, ndersa sholla duhet te jete celik kunder shpimit. Gjatesia e cizmes duhet te jete te pakten 36 cm dhe nuk duhet te jete me shume se 2.5 kg ne menyre qe mos te krijojte veshtiresi per operatorin gjate punimit. Cizmja duhet te jete anti-statike ne menyre qe te ofroje mbrojtje nga kontakti elektrik. Cdo parameter I cizmes duhet te jete ne perputhje me standardin ISO 20345 ose ekuivalent.

3. Kepuce pune

Kepucet e punes duhet te jene te ndertuara me lekure dhe nuk duhet te fusin uje. Klasa e sigurise se kepuces nuk duhet te jete me pak se klasa S3. Kepuca duhet te duroje goditje te medha me nje madhesi jo me pak se 1980 J. Maja e kepuces duhet te jete e pajisur me mbrojtje te perforcuar celiku dhe sholla e poshtme duhet te jete me celik dhe duhet te jete rezistente ndaj shpimit. Goma e poshtme e kepuces duhet te jete e modeluar ne menyre te tille qe te jete kunder rreshkitjes ndaj vajrave dhe karburanteve te ndryshme. Pjesa e thembres duhet te jete me amortizim dhe duhet te perthithe energjine e ecjes. Kepuca duhet te jete antistatike ne menyre te tille qe te krijojte siguri te plote te operatori. Modelimi I kepuces duhet te jete ne perputhje me standardin ISO 20345 S3, ISO 20345 SRC ose ekuivalent.

4. Jelek fosforeshent

Jeleku duhet te jete me thurrje te perdhredhura dhe materiali duhet te jete 100% poliester. Jeleku duhet te kete aftesi dukshmerie shume te larta, duhet te kete ngjyre portokalli ne perputhje me standardin ISO 20471 ose ekuivalent. Jeleku duhet te jete I lehte ne menyre te tille qe mos te krijojte pengesa gjate punimit, mbyllja duhet te behet me ane te materialit "Velcro" ose ekuivalent dhe duhet te jete I certifikuar per te rezistuar mbi 45 larje. Jeleku nuk duhet te kete me pak se dy shirita reflektues vertikal dhe dy shirita reflektues horizontal ne menyre te tille qe te sigurohet dukshmeri e plote. Prerja e jelekut duhet te jete e tille qe te siguroje nje komfort total te operatorit. Jeleku duhet te kete te stampuar ne anen e majte stemen e "Ujesjelles Kanalizime Tirane UKT sh.a" dhe gjithashtu ne gjithte pjesen e pasme te tij. Jeleku duhet te jete I modeluar ne perputhje me standardet ISEA 107 R 2; ISEA 107 P 2; NZS 4602.1 D/N; NZS 1906.4 ose ekuivalent te tyre.

5. Xhupa me logo UKT

Xhupi duhet te jete I ndertuar ne menyre te tille qe te siguroje mbrojtje te plote nga te gjitha kushtet e motit. Duhet te jete me material 100% poliester dhe duhet te kete nje shtrese PVC per mbrojtje te plote. Xhupi duhet te kete aftesi te parandalimit te futjes se ujit dhe duhet te kete nje shtrese leshi ose ekuivalente per te krijuar komfort dhe ngrohtesi ne kushte te veshtira klimaterike. Menget e xhupit duhet te jene te rregullueshme te pjesa e kycit dhe duhet te jene te pajisura me shtrengues "Velcro" ose ekuivalent per te krijuar nje izolim perfekt. Xhupi duhet te kete xhiep per telefonin, xhiep te brendshem ne pjesen e kraharorit dhe 4 xhepa te jashtem per depozitim te sendeve te ndryshme. Mbyllja e xhupit duhet te behet ne pjesen e perparme me zinxhir dhe me nje kapak shtese per mbrojtje ndaj kushteve atmosferike. Qepja e xhupit duhet te jete hermetike per te krijuar nje mbrojtje me te madhe ndersa pjesa e belit duhet te jete elastike per te krijuar nje pershtatje te rehatshme dhe te sigurt. Xhupi duhet te kete te stampuar ne anen e majte stemen e "Ujesjelles Kanalizime Tirane UKT sh.a"

6. Bluze me minge te shkurtra pune me logo UKT

Bluza duhet te jete e modeluar me material poliester, jo me shume se 70% dhe me material pambuku jo me pak se 30%, menget duhet ti kete te shkurtra. Bluza duhet te jete e rehatshme dhe e ndertuar me thurrje "Marcella" ose ekuivalente. Qepja e bluzes duhet te jete e dyfishte per te siguruar rezistence me te madhe dhe faktori I mbrojtjes ndaj rrezeve ultravjollce nuk duhet te jete me pak se 40+, duhet te sigurohet nje bllokim I rrezeve te pakten 97%. Bluza duhet te jete me te pakten 3 kopsa dhe me jake te kthyer. Menget nuk duhet te jene me te shkurtra se 22 cm dhe nuk duhet te jene me te gjata se 27 cm. Gjatesia e bluzes nuk duhet te jete me shume se 82 cm, ne varesi te madhesis se ofruar. Madhesia e ofruar duhet te jete nga XS deri ne 5XL. Ngjyra e bluzes duhet te jete blu e erret. Ne anen e majte te pjeses se perparme duhet te jete e stampuar stema "Ujesjelles Kanalizime Tirane UKT sh.a".

7. Bluze me minge te gjata me logo UKT.

Bluza duhet te jete me minge te gjata dhe duhet te jete kombinim I materialit poliester dhe pambuk, jo me shume se 70% poliester dhe jo me pak se 30% pambuk. Bluza duhet te krijojte rehati gjate punimit. Thurrja e bluzes duhet te jete "Marcella" ose ekuivalent dhe qepja duhet te jete e dyfishte per te ofruar rezistence me te madhe. Jaka duhet te jete e kthyer dhe mbyllja duhet te jete me te pakten 3 kopsa. Faktori I mbrojtjes ndaj rrezeve ultravjollce nuk duhet te jete me pak se 40+, duhet te sigurohet nje bllokim I rrezeve te pakten 97%. Menget e bluzes nuk duhet te jene me pak se 62 cm dhe jo me shume se 70 cm, ndersa gjatesia e bluzes duhet te jete midis diapazonit 75 – 79cm, ne varesi te madhesis (S, M, L). Bluza duhet te kete madhesi te ndryshme, duke filluar nga XS dhe deri te 4XL. Ne anen e majte te pjeses se perparme duhet te jete e stampuar stema "Ujesjelles Kanalizime Tirane UKT sh.a".

8. Kominoshe pune kundra ujit.

Kominoshet duhet te ofrojne mbrojtje te plote ne cdo shtate te veshtire atmosferike, duhet te jene material poliester 100% dhe duhet te jene te veshura me nje shtrese PVC. Seti duhet te perfshije pjesen e poshtme te pantallonave dhe pjesen e siperme ne forme xhakete. Xhaketa duhet te jete me te pakten dy xhepa ne pjesen e perparme, nje kapuc dhe me mundesi per ajrosje

dhe ventilim ne pjesen e pasme. Ne pjesen e perparme duhet te jete e pajisur me zinxhir ne menyre qe te krijojte lehtësi gjate veshjes. Menget e xhaketes duhet te jene ne pjesen e brendshme pjese elastike ne menyre qe te jete e izoluar plotesisht nga penetrimi I ujit. Pantallonat duhet te jene te pajisura me jo me pak se dy xhepa ne pjesen anesore te kembeve dhe duhet te jene pjesen e belit plotesisht elastike per te krijuar lehtësi per t'u veshur dhe komoditet gjate punimit. Qepjet e xhaketes dhe te pantallonave duhet te jene te izoluar per te ndaluar futjen e ujit. Kominoshet duhet te jene te prodhuara ne perputhje te plote me standardin ISO 24232 ose ekuivalent. Gjatesia e pantallonave duhet te jete midis diapazonit 106 – 115 cm ndersa gjatesia e xhaketes duhet te jete jo me pak se 74 cm dhe jo me shume se 85 cm. Masat e setit duhet te ofrohen nga madhesia S deri ne XXXL.

9. Doreza Pune

Dorezat e punes duhet te jene elastike dhe me material poliester, duhet te ofrojne mbrojtje te plote te duarve. Pjesa e pellembes duhet te jete e veshur me shtresen nitrile ose ekuivalente ne menyre te tille qe te krijohet rezistence ndaj gerryerjes. Dorezat duhet te jene peshe te lehte dhe nuk duhet te krijojne veshtiresi gjate punimit dhe duhet te jene pa qepje. Materiali I dorezes nuk duhet te krijojte pushitje dhe duhet te siguroje ajrosje perfekte. Doreza duhet te kete te pakten 2 thurrije per 1 cm² ne menyre qe te garantohet rehati maksimale. Cdo parameter I dorezes duhet te jete ne perputhje me standardin EN 420 ose ekuivalent dhe standardin EN 388 ose ekuivalent. Doreza duhet te ofroje siguri kundrejt prerjes ne parametrat midis 200 g deri ne 498 g te ngarkeses se prerjes ne perputhje me standardin ISEA 105 ose ekuivalent.

10. Mushama shiu

Mushamaja duhet te jete me material poliester 100% dhe duhet te kete nje veshje PVC per ndalimin e depertimit te ujit. Menget duhet te jene elastike ne pjesen e brendshme dhe gjatesia e tyre duhet te jete te pakten 81 – 88 cm, ne varesi te mases. Mushamaja duhet te kete vrime nga pas per ajrosje dhe ventilim te vazhdueshem. Mbyllja e mushamase duhet te behet me nje zinxhir ne pjesen e perparme dhe qepja duhet te jete e izoluar me ngjites per te krijuar nje mbrojtje me te madhe. Mushamaja duhet te jete e pajisur me nje kapuc I cili mund te fshihet nen jake. Gjithashtu mushamaja duhet te jete e pajisur me te pakten dy xhepa per te vendosur sende te ndryshme gjate operimit. Faktori I mbrojtjes ndaj rrezeve ultravjollce nuk duhet te jete me pak se 40+, duhet te sigurohet nje bllokim I rrezeve te pakten 97%. Cdo parameter I mushamase duhet te jete sipas standardit EN 343 ose ekuivalent. Mushamaja duhet te ofrohet ne madhesi S deri ne 4XL.

11. Mbrojtese koke e pajisur me ndricues LED.

Mbrojtjesja e kokes duhet te kete te instaluar ne trup nje drite te levizshme per te krijuar nje ambient te ndricuar ne kantiere pune te erreta. Materiali I jashtem i mbrojteses duhet te jete pambuk. Drita LED duhet te jete te pakten me tre modalitete ndricimi, nje modalitet per ndricim te ulet, nje modalitet per ndricim te larte dhe nje modalitet per ndricim pulsues. Ndricimi duhet te jete te pakten 145 lm dhe koha e operimit nuk duhet te jete me pak se 100 min per ndricim te larte dhe jo me pak se 220 min per ndricim te ulet. Bateria e ndricuesit duhet te jete Li-ION, e rikarikueshme dhe karikimi duhet te behet me ane te nje porte USB. Pjesa e brendshme e mbrojteses duhet te jete me material ABS ose ekuivalent ne menyre qe te kryejte zbutjen e goditjeve. Mbrojtjesja duhet te jete e pajisur me nje strehe jo me te shkurter se

2.5 cm ne menyre qe te siguroje fushepamje te gjere. Mbrojtesja e kokes duhet te jete ne perputhje me rregulloren e Bashkimit Europian 2016/425 dhe duhet te kete markimin CE.

12. Xhakete per punime ne kushte ekstreme

Xhaketa duhet te jete e perbere nga material 100% poliester dhe pjeset anesore duhet te jene elastike per te ofruar lehtësi ne levizje. Pjesa e brendshme duhet te jete e pajisur me perberje leshi per te rritur nivelin e rehatise dhe nxehtesise. Xhaketa duhet te kete 3 nivele te ndryshme ngrohjeje: nivel te ulet, nivel mesatar dhe nivel te larte, dhe nivelet duhet te komandohen nga nje buton I cili duhet te jete ne pjesen e jashtme te xhaketes. Shperndarja e nxehtesise duhet te behet ne te pakten 3 siperfaqe te ndryshme te trupit: ne pjesen e pasme, ne pjesen e gjoksit dhe ne te dy xhepat anesor. Xhaketa duhet te kete te pakten kater xhepa funksional dhe nje xhepa ekstra per vendosjen e burimit te ushqimit. Madhesite e xhaketes duhet te mundesohen nga masa S deri ne masen XXXL. Burimi I ushqimit duhet te jete te pakten 18V, jo me pak se 5.8Ah, e tipit Li-Ion dhe duhet te siguroje te pakten 34 ore punim ne nivelin e ulet te ngrohjes. Koha e plote e karikimit nuk duhet te jete me shume se 60 min. Burimi I ushqimit duhet te jete I pajisur me nje tregues LED te nivelit te baterise I cili duhet te sinjalizojë operatorin per nivelin e burimit te ushqimit e të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

13. Cizme llastiku kunder rrymes elektrike

Çizmet e sigurisë të jenë ideale për përdorime te ndryshme dhe te kene disa karakteristika si: rezistente ndaj vajrave, acideve dhe absorbimit të ngarkesave elektrike. Çizmet të jene te pajisura me shtresë metalike në pjesën e poshtme dhe pjesën e përparme duke i ofruar këmbës një mbrojtje maksimale kundër dëmtimeve gjatë punës.

Materiali : PVC/Çelik
• □ Ngjyra : Sipas kërkesës së AK
• Masa : 41-44

14. Kepece pune per femra

Kepucet duhet te jene te rehatshme. Ato duhet te ofrohen ne numra te ndryshem sipas kerkese se AK-se. Fotoja me poshte eshte ilustruese:



15. Jelek dimri

Të ofrojë cilësi dhe fleksibilitet i lartë me më shumë ngrohtësi, dy xhepa portokalli fosforeshent portokalli të thellë në të dyja anët dhe shiritar e reflektues ngjyrë gri.

Veçoritë

Pëlhurë e fortë poliester/pambuk Shirit reflektues për më shumë dukshmëri

Xhepa përpara

Me Shtresë dhe mbushje të plotë për të mbajtur ngrohtësinë e trupit

pëlhurë e klasifikuar me UPF 40+ për të bllokuar 98% rrezeve UV

Shtresë e sipërfaqësore Anti Vaj, Anti Uje dhe Anti Njolle

Certifikim SSH/CE

Certifikuar sipas SSH/EN ISO 20471 pas larjes 25

Përputhet me standartin SSH/EN ISO 20471

Materialet:

Pëlhura Jashtme/Kryesore: 80% Poliestër, 20% Pambuk 280g

Materiali Shtrese: 100% Poliestër, 200g

Astari: 65% Poliestër, 35% Pambuk, 260g

STANDARTET

SSH/EN ISO 20471 Klasi 2

16. Cante pune

17. Xhakete me logo

Pelhurë e butë poliester/pambuk, pëlhura e jashtme/ kryesore 65% poliester, 35% pambuk me shtrese të butë. Pesha 280 ± 10 gr/m². Pjesa elastike inovative në zonat kryesore të lëvizjes siguron rehati dhe fleksibilitet të shkëlqyer. Xhepa per ruajtje, xhepa me velkrof ne kraharor, shirit i holle reflektues. Menge te para-kerrusur qe lejojne rritjen e lirise se levizjes. Te gjitha pikat e dobeta te perforcuara, pelhure e klasifikuar me UPF 40+ per te bllokuar 98% te rrezeve UV.

Certifikim SSH/CE

Ngjyra: Sipas kërkesës së AK

18. Perparese per sanitaret me logo

Materiali të jetë 65% polyester dhe 35% pambuk, pesha 240 ± 10 gr/m².

Përparëse pune profesionale për të plotësuar të gjitha nevojat për kushtet e punës. Pjesa e pasme të jetë me ajrosje për rehati, përparësja të këte si vecori mbyllje të parme të fshehur dhe kombinon dy xhepa të poshtem sebashku me nje xhep te vetem ne kraharor.

Ruajtje ekselente ndaj bojës dhe plotesisht anti-tkurrije, kjo veshje pune moderne do e mbaje pamjen e saj te fresket pas cdo larjeje. Larje ne lavatrice ne temp mesatare, deri ne 60°.

19. Këmishë zyre per meshkuj

Këmisha dimërore të jetë sa më komforte, ngjyrë e bardhë, cilësia e parë, 30% poliestër dhe 70% pambuk, pesha $130 \pm$ gm² me këtë përshkrim:

Prerja e këmishës të jetë klasike.

Për meshkujt këmisha ka jakën, mëngët dhe xhep. Për femra këmisha ka jakën, mëngët, pa xhep. Fundi këmishes është në formë harku.

Jaka e këmishës të ketë formë të mbyllur klasike duke krijuar mundësinë që kollaritja të jetë fine.

Jakës do ti vendoset kravatë e cila do të jetë 100% poliestër ose një material ekuivalent me të, pesha e së cilës do të jetë 180gr/m², në ngjyrë blu të errët.

Xhepi në këmishat e meshkujve të jetë me përmasa standarte, pa kapak ku të jetë i pozicionuar në krahun e majtë të këmishës. Sipër xhepit të qëndiset logoja e AK-së.

Ne këmishat e femrave qëndiset logoja e AK-së.

Këmisha ka vrima në krahun e majtë për meshkujt dhe në krahun e djathtë për femrat dhe kopsat në krahun e djathtë për meshkujt dhe në krahun e majtë për femrat.

Vrimat do të hapen në mënyrë vertikale. Këmisha duhet të jetë simetrike në të gjithë elementët e saj. Kopsat duhet të jenë të fshehura. Këmishat hekurosen mirë në fund të procesit teknologjik, palosen duke vendosur në xhepa karton dhe në jakë fibër pl

20. Pantallona zyre per meshkuj

Përshkrimi; Pantallona në prerje klasike. Materiali i pantallonave të jetë 80% lesh dhe 20% poliestër. Pesha e tyre të variojë 260-280 gr/m². Pantallonat të kenë dy xhepa te pjerret përpara, duke krijuar pamjen klasike të tyre dhe fine.

Ngjyra: Blu e errët; pantone 296

21. Kollare per meshkuj

Kravata të jetë material poliestër viskoz në ngjyrë blu të errët.

Material poliestër viskoz, ngjyrë blu e errët me logo me qëndisje. Pesha e kravatës të jetë 180gr/m². Prerja e saj të jetë klasike.

22. Shalle per femra

Shalli të jetë material poliestër viskoz, në ngjyrë blu të errët. Pesha e shallit të jetë 100-120gr/m².

Shalli të jetë drejtëkëndor me gjerësi 15 cm dhe gjatësia e tij të jetë 140 cm

Shalli me material poliestër viskoz, ngjyrë blu e errët me logo me qëndisje.

23. Funde per femra

Përshkrimi; Fund në prerje klasike. Materiali i fundit të jetë 80% lesh dhe 20% poliestër. Pesha e tyre të variojë 260-280 gr/m².

Ngjyra: Blu e errët; pantone 296

24. Pantallona per femra

Përshkrimi; Pantallona në prerje klasike. Materiali i pantallonave të jetë 80% lesh dhe 20% poliestër. Pesha e tyre të variojë 260-280 gr/m². Pantallonat të kenë dy xhepa te pjerret përpara, duke krijuar pamjen klasike të tyre dhe fine.

Ngjyra: Blu e errët; pantone 296

25. Kapele dielli me logo

Kapele dielli me 6 panele, Me strehe te gjate plastike e veshur me dokun e vet, me perforcim ne kupe, me rrip prapa per rregullimin e gjerësisë. Pesha: 240-260 gr m².

26. Këpuce kunder rrymes elektrike.

Këpuce pune, prodhuar nga lëkurë ngjyrë e zezë, antistatike, shuall me densitet të dyfishtë, jo të pajisura me shtresa metalike, majë mbrojtëse për gishtat.

Këpuçët profesionale duhet të jenë prodhuar në përputhje me standartin e sigurisë në punë SSH/EN ISO 20347 ose ekuivalent.

Referuar standartit të mësipërm, këpuca duhet të plotësojë specifikimet bazike si mëposhtë vijon: *Këpuce antistatike*

Mbrojtësja e gishtave komposite per nje mbrojte maksimale

Sholle e mesme Anti-Shpim Komposite

Sistem të absorbimit të energjisë

Membrane 100% Ujedaluese

Sholle Anti-Rreshkitje (SRC)

Rezistente ndaj nxehtësisë

Sholle rezistente ndaj vajrave

Shuall me densitet te dyfishte

100% jo metalike

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Dokumentin pdf të emërtuar 2.3_Oferta_teknike
- Dokumentin pdf të emërtuar 2.4_Raporte_testimi
- Dokumentin pdf të emërtuar 2.8_KATALOG_ISMONT
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_e_jelek_H110
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_jelek_portokall
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_e_jelek_H100_H110+
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_e_kominosheve
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_e_setit_xhaketë_kundra_shiut_ff
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_CERTIFIKATE_JELEK_h130_H130+

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është:*

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.5. Në nenin 3 Parime të përgjithshme: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me

transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.6. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që

operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Ndërsa në nenin 79, po këtu thuhet se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

- a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;*
- b) efijencës së energjisë;*
- c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.*

3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.1.7. Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij,

*brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose
b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose
c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

III.1.8. Në nenin 1 “Qëllimi” e ligjit Nr. 116 datë 11.09.2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet: *“Ky ligj përcakton rregulla për krijimin, organizimin dhe funksionimin e sistemit të akreditimit të organeve të vlerësimit të konformitetit që kryejnë aktivitete të vlerësimit të konformitetit”.*

III.1.9. Në nenin 2 “Fusha e zbatimit” e ligjit Nr. 116 datë 11.09.2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet: *Ky ligj zbatohet në çdo rast akreditimi, pavarësisht nëse organi i vlerësimit të konformitetit kryen aktivitete të vlerësimit të konformitetit në fushën vullnetare apo të detyrueshme dhe pavarësisht nëse vlerësimi është i detyrueshëm apo vullnetar.*

III.1.10. Në nenin 3 “Përkufizime” e ligjit Nr. 116 datë 11.09.2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet: *“Akreditim” është dëshmia/certifikata e lëshuar nga organizmi kombëtar i akreditimit për organin e vlerësimit të konformitetit, që përmbush kërkesat e përcaktuara në standardet e harmonizuara dhe, sipas rastit, çdo kërkesë shtesë, përfshirë ato të vendosura në skemat përkatëse sektoriale, për kryerjen e një veprimtarie specifike të vlerësimit të konformitetit. “Organizëm kombëtar i akreditimit” është organizmi i vetëm që kryen akreditimin me autoritetin e dhënë nga ligji. 3. “Certifikatë akreditimi” është një dokument ose një tërësi dokumentesh zyrtare, që deklarojnë akreditimin për një fushë të përcaktuar. “Vlerësim konformiteti” është procesi që provon nëse janë përmbushur kërkesat e specifikuar për një produkt, proces, shërbim, sistem, person ose organ. “Organ i vlerësimit të konformitetit” është çdo organ që kryen veprimtari të vlerësimit të konformitetit, përfshirë kalibrimin, testimin, certifikimin dhe inspektimin.*

III.1.11. Në nenin 5 “Procesi i Akreditimit” e ligjit Nr. 116 datë 11.09.2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet: 1. *Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit akrediton:*

- a) laboratorë testues, mjekësorë dhe kalibrues;*
- b) organe certifikuese të sistemeve të me- naxhimit;*
- c) organe certifikuese të personelit;*
- ç) organe certifikuese të produkteve;*
- d) organe inspektuese;*
- dh) organe që realizojnë teste zotësie dhe krahasime ndërlaboratorike;*
- e) organe që prodhojnë materiale referuese të certifikuar.*

III.1.12. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e

gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.13. Në rastin konkret, referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues “Malbertex” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF me arsyetimin se “*Lidhur me vlerësimin e KVO-së për përmbushjen e kriterit kualifikues të pikës 2.4 të shtojcë 7 të DST-ve duke e kualifikuar konkurentin Vojsava Zenelaj PF kemi bindjen se anëtarët e KVO-së nuk e kanë kuptuar këtë kriter dhe janë mjaftuar vetëm me konstatimet se ky konkurent ka dorëzuar raporte testimi, duke e kualifikuar, por lidhur me këtë kriter ne pretendojmë se ky konkurent nuk e plotëson për arsyet e mëposhtme: Dëshmia e testimi zyrtar ose raport i testimi i paraqitur nga ky konkurent për artikullin pantallona pune nuk vërteton përmbushjen e standartit ISO 13688 ose ekuivalent, pasi dëshmia e testimi zyrtar ose raporti i testimi nuk është lëshuar për kompaninë prodhuese dhe për emërtimin e produktit dhe për kodin e produktit të deklaruar nga ana e këtij konkurenti në ofertën teknike. Gjithashtu dëshmia e testimi zyrtar ose raporti i testimi i paraqitur nga ky konkurent për artikullin pantallona pune përa i përket përmbushjes së standardit ISO 13688 ose ekuivalent nuk është lëshuar nga laboratorë i akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, pasi laboratorit që e ka lëshuar nuk është i akredituar për të kryer analizë lidhur me përmbushjen e standartit ISO 13688 ose ekuivalent...”, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se në shtojcën 7, pika 2.4 të dokumenteve të tenderit, të modifikuara, përcaktohet se “**2.4.Dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare (raporte testimi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyrueshme të njëjta).**Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti EN ose ekuivalente duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të*

shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara sipas rregullores EU nr 425/2016, ose ekuivalente”. Në shtojcën 5 “Specifikimet teknike”, të dokumenteve të tenderit, për artikullin pantallona pune përcaktohet se : *“Pantallonat e punes duhet te jene te perbera nga jo me shume se 70% poliester dhe jo me pak se 30% pambuk. Materiali duhet te jete I tille qe mos te krijojte rrudha dhe tkurrje. Duhet te sigurohet rehati maksimale dhe performance e larte. Per te krijuar lehtësi ne pune, pantallonat duhet te jene te pajisura me te pakten 6 xhepa te ndryshem. Dy prej xhepave duhet te jene te medhenj dhe duhet te jene te pozicionuar te pjesa anesore e kembeve, duhet te jene me mbyllje me “Velcro” ose ekuivalente. Dy prej xhepave duhet te jene ne pjesen e pasme dhe dy te tjere duhet te jene ne pjesen e perparme. Pantallonat duhet te jene me qepje te perforcuar dhe me perforcim ekstra ne pjeset e dobeta ne menyre te tille qe te kalojne veshitresite e krijuara nga ambienti I punes. Faktori I mbrojtjes te rrezeve ultravjollce duhet te jete te pakten 40+ dhe duhet te sigurohet nje bllokim I rrezeve jo me pak se 97%. Pantallonat duhet te jene te pajisura me zinxhir ne pjesen e perparme dhe shtrengimi te pjesa e belit duhet te mundesohet nga nje kopse. Pantallonat duhet te jene te modeluara ne perputhje me standardin BS 22526-1 ose ekuivalent. Ngjyra e pantallonave duhet te jete blu e erret”*. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se në përmbushje të kriterit operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektornik ofertën teknike, ku ka përcaktuar emërtimin e produktit, kompaninë prodhuese, emërtimin e katalogut, referenca në katalog/kod produktit ose nr. i faqes në katalog, si dhe shënime. Gjithashtu, operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF ka ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik raport testimi të realizuar nga laboratorit Fiziko Mekanik dhe Kimik i Tekstilit dhe Lëkurës (Universiteti Politeknik i Tiranës), akredituar nga Drejtoria e Akreditimit, sipas S SH ISO/IEC 71025:2017. Konkretisht operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” Pf ka dorëzuar raporte testimi nr. A2-60, nr. A2-59, nr. A2-61, nr. A2-62, nr. A2-63, nr. A2-64, nr. A2-65, nr. A2-66, nr. A2- 67, nr. A2-68, nr. A2-69, nr. A2-55, nr. **A2-54**, nr. L2-13, A2-56, A2-58, A2-57, nr. A2-70, nr. A2-71, nr. A2-72, nr. A2-73, nr. A2-74, nr. L2-14, si dhe katalogun ISMONT të përkthyer dhe noterizuar. Referuar pikës 2.4 të shtojcës 7 kriteret e veçanta të kualifikimit të modifikuar, autoriteti kontraktor ka kërkuar **2.4. Dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare (raporte testimi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta).Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti EN ose ekuivalente duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara sipas rregullores EU nr 425/2016, ose ekuivalente.**, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka kërkuar raporte testimi të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare/ndërkombëtare.

Në kuadër të shqyrtimit administrativ të ankesës, në mënyrë sa më transparente dhe të drejtë Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se për sqarimin e fakteve kërkohen verifikime të posaçme pranë organeve kompetente si Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, si institucioni i vetëm publik, i cili në bazë të ligjit nr. 116, datë 11.09.2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 4 të tij thuhet, se “Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit është i vetmi organizëm kombëtar që kryen akreditimin e organeve

të vlerësimit të konformitetit”. Nga verifikimi në ueb-in <http://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>, kryer në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, Komisioni konstaton se laboratorit Fiziko Mekanik dhe Kimik i Tekstilit dhe Lëkurës (Universiteti Politeknik i Tiranës) rezulton, që është laborator i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për analizat kimike të lëkurës, fibrave dhe tekstilit.

Për rrjedhojë, operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF me raport - testimet e dorëzuara, përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit për dorëzimin e raport testeve të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare/ndërkombëtare.

Akoma më tej, referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues “Malbertex” SHPK me arsyetimin se *“Dëshmia e testimit zyrtar ose raport i testimit i paraqitur nga ky konkurent për artikullinpantallona pune nuk vërteton përmbushjen e standartit ISO 13688 ose ekuivalent, pasi dëshmia e testimit zyrtar ose raporti i testimit nuk është lëshuar për kompaninë prodhuese dhe për emërtimin e produktit dhe për kodin e produktit të deklaruar nga ana e këtij konkurenti në ofertën teknike. [...]”*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ISO e kërkuar nga autoriteti kontraktor në shtojcën 5 “Specifikimet teknike” për secilin prej artikujve, konkretisht për artikullin pantallona pune si vijon: *“[...]Pantallonat duhet të jene të modeluara në përputhje me standardin ISO 13688 ose ekuivalent. Ngjyra e pantallonave duhet të jete blu e errët.”*, nuk është për metoda prove, dhe se laboratorit nuk teston mbi standardet e vendosura nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike, por teston mbi standardet për të cilat është akredituar. Konkretisht ISO 13688 është një informacion që duhet të jepet nga prodhuesi me veshjet mbrojtëse dhe nuk i referohet standardit për të cilin laboratorit duhet të jetë i akredituar.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Malbertex” SHPK nuk qëndron.

III.2 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Malbertex” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF me arsyetimin, se *“Dëshmia e testimit zyrtar ose raport i testimit i paraqitur nga ky konkurent për artikullin çizme llastiku nuk vërteton përmbushjen e standartit ISO 20345 ose ekuivalent, pasi dëshmia e testimit zyrtar ose raporti i testimit nuk është lëshuar për kompaninë prodhuese dhe për emërtimin e produktit dhe për kodin e produktit të deklaruar nga ana e këtij konkurenti në ofertën teknike. Gjithashtu, dëshmia e testimit zyrtar ose raporti i testimit i paraqitur nga ky konkurent për artikullin çizme llastiku për sa i përket përmbushjes së standartit ISO 20345 ose ekuivalent nuk është lëshuar nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, pasi laboratorit që e ka lëshuar nuk është i akredituar për të kryer analizë lidhur me përmbushjen e standartit ISO 20345 ose ekuivalent”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1 Në shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë:

Ne kriteret e vecanta të kualifikimit perkatesisht në pikën 2.4 është kërkuar si më poshtë vijon:

Ishte :

2.4. Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (raporte testimi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë - analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta). Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standardi EN ose ekuivalente duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara me rregulloren EU nr 425/2016, ose ekuivalente.

Behet:

2.4.Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (raporte testimi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta).Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti EN ose ekuivalente duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara sipas rregullores EU nr 425/2016, ose ekuivalente.

III.2.3 Në shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit, shtojca 5 ”Specifikimet teknike”, është modifikuar si më poshtë vijon:

1. Cizme llastiku

Cizmet duhet te ofrojne siguri dhe komfort gjate punimit, duhet te jene kompozim I materialit PVC. Cizmja duhet te jete e ndertuar ne menyre te tille qe t’I rezistojte ambienteve ne kantieret e ndertimit dhe te ofroje siguri nga renia e objekteve te ndryshem. Sholla e cizmeve duhet te jete ergonomike dhe duhet te kete kaluar kushtet e testimit te antireshkitjes ne pllaka qeramike dhe kushtet e testimit te antireshkitjes ne sipërfaqe me vaj dhe sipërfaqe metalike, duhet te jete rezistente ndaj hidrokarbureve, tretesirave te ndryshme dhe permbajtjeve acide. Cizmja duhet te jete e pajisur me shtrese metaliku ne pjesen e majes dhe me shtrese mbrojtese ne pjesen e kyceve, ndersa sholla duhet te jete celik kunder shpimit. Gjatesia e cizmes duhet te jete te pakten 36 cm dhe nuk duhet te jete me shume se 2.5 kg ne menyre qe mos te krijojte veshtiresi per operatorin gjate punimit. Cizmja duhet te jete anti-statike ne menyre qe te ofroje mbrojtje nga kontakti elektrik. Cdo parameter I cizmes duhet te jete ne perputhje me standardin ISO 20345 ose ekuivalent.

III.2.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Dokumentin pdf të emërtuar 2.3_Oferta_teknike
- Dokumentin pdf të emërtuar 2.4_Raporte_testimi
- Dokumentin pdf të emërtuar 2.8_KATALOG_ISMONT
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_e_jelek_H110
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_jelek_portokall
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_e_jelek_H100_H110+
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_e_kominosheve
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_e_setit_xhaketë_kundra_shiut_ff
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_CERTIFIKATE_JELEK_h130_H130+

III.2.5. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi

të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.2.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt - prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.7. Në rastin konkret, referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues “Malbertex” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF me arsyetimin se: “*Dëshmia e testimi zyrtar ose raport i testimi i paraqitur nga ky konkurent për artikullin cizme llastiku nuk vërteton përmbushjen e standartit ISO 20345 ose ekuivalent, pasi dëshmia e testimi zyrtar ose raporti i testimi nuk është lëshuar për kompaninë prodhuese dhe për emërtimin e produktit dhe për kodin e produktit të deklaruar nga ana e këtij konkurenti në ofertën teknike. Gjithashtu dëshmia e testimi zyrtar ose raporti i testimi i paraqitur nga ky konkurent për artikullin cizme llastiku përse i përket përmbushjes së standardit ISO 20345 ose ekuivalent nuk është lëshuar nga laboratorë i akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specififikimet teknike, pasi laboratorit që e ka lëshuar nuk është i akredituar për të kryer analizë lidhur me*

*përmbushjen e standartit ISO 20345 ose ekuivalent”, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në shtojcën 7 pika 2.4 të dokumenteve të tenderit të modifikuar përcaktohet se “2.4.Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (raporte testimi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta).Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti EN ose ekuivalente duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara sipas rregullores EU nr 425/2016, ose ekuivalente”. Në shtojcën 5 “Specifikimet teknike”, të dokumenteve të tenderit të ndryshuara për artikullin cizme llastiku përcaktohet se : “ Cizmet duhet te ofrojne siguri dhe komfort gjate punimit, duhet te jene kompozim I materialit PVC. Cizmja duhet te jete e ndertuar ne menyre te tille qe t’I rezistojne ambienteve ne kantieret e ndertimit dhe te ofroje siguri nga renia e objekteve te ndryshem. Sholla e cizmeve duhet te jete ergonomike dhe duhet te kete kaluar kushtet e testimit te antireshkitjes ne pllaka qeramike dhe kushtet e testimit te antireshkitjes ne sipërfaqe me vaj dhe sipërfaqe metalike, duhet te jete rezistente ndaj hidrokarbureve, tretesirave te ndryshme dhe permbajtjeve acide. Cizmja duhet te jete e pajisur me shtrese metaliku ne pjesen e majes dhe me shtrese mbrojtese ne pjesen e kyceve, ndersa sholla duhet te jete celik kunder shpimit. Gjatesia e cizmes duhet te jete te pakten 36 cm dhe nuk duhet te jete me shume se 2.5 kg ne menyre qe mos te krijojne veshtiresi per operatorin gjate punimit. Cizmja duhet te jete anti-statike ne menyre qe te ofroje mbrojtje nga kontakti elektrik. Cdo parameter I cizmes duhet te jete ne perputhje me standardin ISO 20345 ose ekuivalent”, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se në përmbushje të kriterit, operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektornik ofertën teknike, ku ka përcaktuar emërtimin e produktit, kompaninë prodhuese, emërtimin e katalogut, referenca në katalog/kod produktit ose nr. i faqes në katalog, si dhe shënime. Gjithashtu, operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF ka ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik raport testimi të realizuar nga laboratorit Fiziko Mekanik dhe kimik i tekstitit dhe lëkurës (Universiteti Politeknik i Tiranës), akredituar nga Drejtoria e Akreditimit, sipas S SH ISO/IEC 71025:2017. Konkretisht operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” Pf ka dorëzuar raporte testimi nr. A2-60, nr. A2-59, nr. A2-61, nr. A2-62, nr. A2-63, **nr. A2-64**, nr. A2-65, nr. A2-66, nr. A2- 67, nr. A2-68, nr. A2-69, nr. A2-55, nr. A2-54, nr. L2-13, A2-56, A2-58, A2-57, nr. A2-70, nr. A2-71, nr. A2-72, nr. A2-73, nr. A2-74, nr. L2-14, si dhe katalogun ISMONT të përkthyer dhe noterizuar. Referuar pikës 2.4 të shtojcës 7 kriteret e veçanta të kualifikimit të modifikuar, autoriteti kontraktor ka kërkuar “2.4.Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (raporte testimi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë - analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta). Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti EN ose ekuivalente duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara sipas rregullores EU nr 425/2016, ose ekuivalente”, Komisioni konstaton, se*

autoriteti kontraktor ka kërkuar raporte testimi të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare/ndërkombëtare.

Në kuadër të shqyrtimit administrativ të ankesës, në mënyrë sa më transparente dhe të drejtë, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se për sqarimin e fakteve kërkohen verifikime të posaçme pranë organeve kompetente si Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, si institucioni i vetëm publik, i cili në bazë të ligjit nr. 116, datë 11.09.2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë” në nenin 4 të tij, thuhet, se “*Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit është i vetmi organizëm kombëtar që kryen akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit*”. Nga verifikimi në ueb-in <http://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>, të kryera në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, Komisioni konstaton, se laborator i Fiziko Mekanik dhe kimik i tekstit dhe lëkurës (Universiteti Politeknik i Tiranës) rezulton, që është laborator i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për analizat kimike të lëkurës, fibrave dhe tekstit.

Për rrjedhojë operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF me raport testimet e dorëzuara, përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit për dorëzimin e raport testeve të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare/ndërkombëtare.

Akoma më tej, referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues “Malbertex” SHPK me arsyetimin, se “*Dëshmia e testimit zyrtar ose raport i testimit i paraqitur nga ky konkurent për artikullin çizme llastiku nuk vërteton përmbushjen e standartit ISO 20345 ose ekuivalent, pasi dëshmia e testimit zyrtar ose raporti i testimit nuk është lëshuar për kompaninë prodhuese dhe për emërtimin e produktit dhe për kodin e produktit të deklaruar nga ana e këtij konkurenti në ofertën teknike. Gjithashtu dëshmia e testimit zyrtar ose raporti i testimit i paraqitur nga ky konkurent për artikullin çizme llastiku përa i përket përmbushjes së standardit ISO 20345 ose ekuivalent nuk është lëshuar nga laboratorë i akredituar sipas standardeve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi[...]*”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, ISO e kërkuar nga autoriteti kontraktor në shtojcën 5 “Specifikimet Teknike” për secilin prej artikujve, konkretisht për artikullin çizme llastiku “...*Cizmja duhet të jete anti-statike në menyre qe te ofroje mbrojtje nga kontakti elektrik. Cdo parameter I çizmes duhet të jete në përputhje me standardin ISO 20345 ose ekuivalent.*”, nuk është për metoda prove, dhe se laborator i teston mbi standardet e vendosura nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike, por teston mbi standardet për të cilat është akredituar. Konkretisht ISO 20345 është një informacion që duhet të jepet nga prodhuesi dhe specifikon kërkesat bazë dhe shtesë për këpucët e sigurisë, që përdoren për qëllime të përgjithshme dhe nuk i referohet standardit për të cilin laborator i duhet të jetë i akredituar.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “Malbertex” SHPK nuk qëndron.

III.3 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Malbertex” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF me arsyetimin se: “*Dëshmia e testimit zyrtar ose raport i testimit i paraqitur nga ky konkurent për artikullin këpucë pune nuk vërteton përmbushjen e standartit ISO 20345 S3 ose ekuivalent dhe standartit ISO 20345 SRC ose ekuivalent ose ekuivalent, pasi dëshmia e testimit zyrtar ose raporti i testimit nuk është*

lëshuar për kompaninë prodhuese dhe për emërtimin e produktit dhe për kodin e produktit të deklaruar nga ana e këtij konkurenti në ofertën teknike. Gjithashtu dëshmia e testimi zyrtar ose raporti i testimi i paraqitur nga ky konkurent për artikullin këpucë pune përa i përket përmbushjes së standardit ISO 20345 S3 ose ekuivalent dhe standartit ISO 20345 SRC ose ekuivalent nuk është lëshuar nga laboratorë i akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specififikimet teknike, pasi laboratorit që e ka lëshuar nuk është i akredituar për të kryer analizë lidhur me përmbushjen e standartit ISO 20345 S3 ose ekuivalent dhe standartit ISO 20345 SRC ose ekuivalent ..”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1 Në shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë:

*Ne kriteret e vecanta te kualifikimit perkatesisht ne piken 2.4 eshte kerkuar si me poshte vijon:
Ishte :*

2.4.Dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare (raporte testimi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specififikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta).Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti EN ose ekuivalente duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara me rregulloren EU nr 425/2016, ose ekuivalente.

Behet:

2.4.Dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare (raporte testimi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specififikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta).Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti EN ose ekuivalente duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara sipas rregullores EU nr 425/2016, ose ekuivalente.

III.3.2 Në shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit, shtojca 5 ”Specifikimet teknike”, është modifikuar si më poshtë vijon:

Kepucet e punes duhet te jene te ndertuara me lekure dhe nuk duhet te fusin uje. Klasa e sigurise se kepuces nuk duhet te jete me pak se klasa S3. Kepuca duhet te duroje goditje te medha me nje madhesi jo me pak se 1980 J. Maja e kepuces duhet te jete e pajisur me mbrojtje te perforcuar celiku dhe sholla e poshtme duhet te jete me celik dhe duhet te jete rezistente ndaj

shpimit. Goma e poshtme e kepuces duhet te jete e modeluar ne menyre te tille qe te jete kunder rreshkitjes ndaj vajrave dhe karburanteve te ndryshme. Pjesa e thembres duhet te jete me amortizim dhe duhet te perthithe energjine e ecjes. Kepuca duhet te jete antistatike ne menyre te tille qe te krijojte siguri te plote te operatori. Modelimi I kepuces duhet te jete ne perputhje me standardin ISO 20345 S3, ISO 20345 SRC ose ekuivalent.

III.3.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Dokumentin pdf të emërtuar 2.3_Oferta_teknike
- Dokumentin pdf të emërtuar 2.4_Raporte_testimi
- Dokumentin pdf të emërtuar 2.8_KATALOG_ISMONT
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_e_jelek_H110
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_jelek_portokall
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_e_jelek_H100_H110+
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_e_kominosheve
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_e_setit_xhaketë_kundra_shiut_ff
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_CERTIFIKATE_JELEK_h130_H130+

III.3.4 Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të

përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.3.5. Në rastin konkret, referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues “Malbertex” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF me arsyetimin se: “Dëshmia e testimit zyrtar ose raporti i testimit i paraqitur nga ky konkurent për artikullin këpucë pune nuk vërteton përmbushjen e standartit ISO 20345 S3 ose ekuivalent dhe standartit ISO 20345 SRC ose ekuivalent ose ekuivalent, pasi dëshmia e testimit zyrtar ose raporti i testimit nuk është lëshuar për kompaninë prodhuese dhe për emërtimin e produktit dhe për kodin e produktit të deklaruar nga ana e këtij konkurenti në ofertën teknike. Gjithashtu, dëshmia e testimit zyrtar ose raporti i testimit i paraqitur nga ky konkurent për artikullin këpucë pune për sa i përket përmbushjes së standartit ISO 20345 S3 ose ekuivalent dhe standartit ISO 20345 SRC ose ekuivalent nuk është lëshuar nga laboratorë i akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, pasi laboratorit që e ka lëshuar nuk është i akredituar për të kryer analizë lidhur me përmbushjen e standartit ISO 20345 S3 ose ekuivalent dhe standartit ISO 20345 SRC ose ekuivalent ..”, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se në shtojcën 7 pika 2.4 të dokumenteve të tenderit të modifikuar përcaktohet se “**2.4.Dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare (raporte testimi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë - analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta). Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standardi EN ose ekuivalente duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara sipas rregullores EU nr 425/2016, ose ekuivalente**”. Në

shtojcën 5 specififikimet teknike të dokumenteve të tenderit për artikullin këpucë pune përcaktohet se : “ *Kepucet e punes duhet te jene te ndertuara me lekure dhe nuk duhet te fusin uje. Klasa e sigurise se kepuces nuk duhet te jete me pak se klasa S3. Kepuca duhet te duroje goditje te medha me nje madhesi jo me pak se 1980 J. Maja e kepuces duhet te jete e pajisur me mbrojtje te perforcuar celiku dhe sholla e poshtme duhet te jete me celik dhe duhet te jete rezistente ndaj shpimit. Goma e poshtme e kepuces duhet te jete e modeluar ne menyre te tille qe te jete kunder rreshkitjes ndaj vajrave dhe karburanteve te ndryshme. Pjesa e thembres duhet te jete me amortizim dhe duhet te perthithe energjine e ecjes. Kepuca duhet te jete antistatike ne menyre te tille qe te krijojte siguri te plote te operatori. Modelimi i kepuces duhet te jete ne perputhje me standardin ISO 20345 S3, ISO 20345 SRC ose ekuivalent”*. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se në përmbushje të kriterit operator ekonomik “Vojsava Zenelaj” SHPK, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik ofertën teknike, ku ka përcaktuar emërtimin e produktit, kompaninë prodhuese, emërtimin e katalogut, referenca në katalog/kod produktit ose nr. i faqes në katalog, si dhe shënime. Gjithashtu, operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF ka ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik raport testimi të realizuar nga laborator Fiziko Mekanik dhe kimik i tekstit dhe lëkurës (Universiteti Politeknik i Tiranës), akredituar nga Drejtoria e Akreditimit, sipas S SH ISO/IEC 71025:2017. Konkretisht operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” Pf ka dorëzuar raporte testimi nr. A2-60, nr. A2-59, nr. A2-61, nr. A2-62, nr. A2-63, nr. A2-64, nr. A2-65, nr. A2-66, nr. A2- 67, nr. A2-68, nr. A2-69, nr. A2-55, nr. A2-54, **nr. L2-13**, A2-56, A2-58, A2-57, nr. A2-70, nr. A2-71, nr. A2-72, nr. A2-73, nr. A2-74, nr. L2-14, si dhe katalogun ISMONT të përkthyer dhe noterizuar. Referuar pikës 2.4 të shtojcës 7, kriteret e veçanta të kualifikimit të modifikuar, autoriteti kontraktor ka kërkuar **2.4.Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (raporte testimi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specififikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë - analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta). Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti EN ose ekuivalente duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara sipas rregullores EU nr 425/2016, ose ekuivalente.**, Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor ka kërkuar raporte testimi të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare/ndërkombëtare.

Në kuadër të shqyrtimit administrativ të ankesës, në mënyrë sa më transparente dhe të drejtë, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se për sqarimin e fakteve kërkohen verifikime të posaçme pranë organeve kompetente si Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, si institucioni i vetëm publik, i cili në bazë të ligjit nr. 116, datë 11.09.2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë” në nenin 4 të tij thuhet se “*Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit është i vetmi organizëm kombëtar që kryen akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit*”. Nga verifikimi në ueb-in <http://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>, kryer në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, Komisioni konstaton, se laborator Fiziko Mekanik dhe Kimik i Tekstit dhe Lëkurës (Universiteti Politeknik i Tiranës) rezulton, që është laborator i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për analizat kimike të lëkurës, fibrave dhe tekstit.

Për rrjedhojë operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF, me raport testimet e dorëzuara përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit për dorëzimin e raport testeve të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare/ndërkombëtare.

Akoma më tej, referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues “Malbertex” SHPK me arsyetimin, se *“Gjithashtu dëshmia e testimit zyrtar ose raporti i testimit i paraqitur nga ky konkurent për artikullin këpucë pune për sa i përket përmbushjes së standardit ISO 20345 S3 ose ekuivalent dhe standardit ISO 20345 SRC ose ekuivalent nuk është lëshuar nga laboratorë i akredituar sipas standardeve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, pasi laboratori që e ka lëshuar nuk është i akredituar për të kryer analizë lidhur me përmbushjen e standardit ISO 20345 S3 ose ekuivalent dhe standardit ISO 20345 SRC ose ekuivalent. [...]”*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ISO e kërkuar nga autoriteti kontraktor në shtojcën 5 “Specifikimet teknike” të dokumenteve të tenderit të modifikuara për secilin prej artikujve, konkretisht për artikullin këpucë pune sipas së cilës *“Modelimi i kepuces duhet të jete ne perputhje me standardin ISO 20345 S3, ISO 20345 SRC ose ekuivalent”*, nuk është për metoda prove, dhe se laboratori nuk teston mbi standardet e vendosura nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike, por teston mbi standardet për të cilat është akredituar. Konkretisht ISO 20345 SRC është një informacion që duhet të jepet nga prodhuesi për pajisjet mbrojtëse personale, këpucët e sigurisë dhe nuk i referohet standardit për të cilin laboratori duhet të jetë i akredituar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Malbertex” SHPK nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Malbertex” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF me arsyetimin se: *“Dëshmia e testimit zyrtar ose raport i testimit i paraqitur nga ky konkurent për artikullin jelek fosforeshent nuk vërteton përmbushjen e standardit ISO 20471 ose ekuivalent, dhe standardit ISEA 107 R 2 ose ekuivalent dhe standardit ISEA 107 P 2 ose ekuivalent dhe standardit NZS 4602 1 D/N ose ekuivalent dhe standardit NZS 1906.4 ose ekuivalent pasi dëshmia e testimit zyrtar ose raporti i testimit nuk është lëshuar për kompaninë prodhuese dhe për emërtimin e produktit dhe për kodin e produktit të deklaruar nga ana e këtij konkurenti në ofertën teknike. Gjithashtu dëshmia e testimit zyrtar ose raporti i testimit i paraqitur nga ky konkurent për artikullin jelek fosforeshent nuk vërteton përmbushjen e standardit ISO 20471 ose ekuivalent, dhe standardit ISEA 107 R 2 ose ekuivalent dhe standardit ISEA 107 P 2 ose ekuivalent dhe standardit NZS 4602 1 D/N ose ekuivalent dhe standardit NZS 1906.4 ose ekuivalent nuk është lëshuar nga laboratorë i akredituar sipas standardeve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, pasi laboratori që e ka lëshuar nuk është i akredituar për të kryer analizë lidhur me përmbushjen e standardit ISO 20471 ose ekuivalent, dhe standardit ISEA 107 R 2 ose ekuivalent dhe standardit ISEA 107 P 2 ose ekuivalent dhe standardit NZS 4602 1 D/N ose ekuivalent dhe standardit NZS 1906.4 ose ekuivalent...”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren,

III.4.1 Në shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë:

Ne kriteret e vecanta te kualifikimit perkatesisht ne piken 2.4 eshte kerkuar si me poshte vijon:

Ishte :

2.4.Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (raporte testimi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta).Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti EN ose ekuivalente duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara me rregulloren EU nr 425/2016, ose ekuivalente.

Behet:

2.4.Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (raporte testimi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta).Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti EN ose ekuivalente duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara sipas rregullores EU nr 425/2016, ose ekuivalente.

III.4.2 Në shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit, shtojca 5, "Specifikimet teknike", është modifikuar si më poshtë vijon:

Jeleku duhet te jete me thurrije te perdhredhura dhe materiali duhet te jete 100% poliester. Jeleku duhet te kete aftesi dukshmerie shume te larta, duhet te kete ngjyre portokalli ne perputhje me standardin ISO 20471 ose ekuivalent. Jeleku duhet te jete I lehte ne menyre te tille qe mos te krijoje pengesa gjate punimit, mbyllja duhet te behet me ane te materialit "Velcro" ose ekuivalent dhe duhet te jete I certifikuar per te rezistuar mbi 45 larje. Jeleku nuk duhet te kete me pak se dy shirita reflektues vertikal dhe dy shirita reflektues horizontal ne menyre te tille qe te sigurohet dukshmeri e plote. Prerja e jelekut duhet te jete e tille qe te siguroje nje komfort total te operatorit. Jeleku duhet te kete te stampuar ne anen e majte stemen e "Ujesjelles Kanalizime Tirane UKT sh.a" dhe gjithashtu ne gjithe pjesen e pasme te tij. Jeleku duhet te jete I modeluar ne perputhje me standardet ISEA 107 R 2; ISEA 107 P 2; NZS 4602.1 D/N; NZS 1906.4 ose ekuivalent te tyre.

III.4.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Dokumentin pdf të emërtuar 2.3_Oferta_teknike
- Dokumentin pdf të emërtuar 2.4_Raporte_testimi
- Dokumentin pdf të emërtuar 2.8_KATALOG_ISMONT
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_e_jelek_H110
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_jelek_portokall
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_e_jelek_H100_H110+
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_e_kominosheve
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_e_setit_xhaketë_kundra_shiut_ff
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_CERTIFIKATE_JELEK_h130_H130+

III.4.4. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.4.5. Në rastin konkret, referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues “Malbertex” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Vojsava Zenelaj” SHPK me arsyetimin se: “Dëshmia e testimit zyrtar ose raport i testimit i paraqitur nga ky konkurent për artikullin jelek fosforeshent nuk vërteton përmbushjen e standartit ISO 20471 ose ekuivalent, dhe standartit ISEA 107 R 2 ose ekuivalent dhe standartit ISEA 107 P 2 ose ekuivalent dhe standartit NZS 4602 1 D/N ose ekuivalent dhe standartit NZS 1906.4 ose ekuivalent pasi dëshmia e testimit zyrtar ose raporti i testimit nuk është lëshuar për kompaninë prodhuese dhe për emërtimin e produktit dhe për kodin e produktit të deklaruar nga ana e këtij konkurenti në ofertën teknike. Gjithashtu dëshmia e testimit zyrtar ose raporti i testimit i paraqitur nga ky konkurent për artikullin jelek fosforeshent nuk vërteton përmbushjen e standartit ISO 20471 ose ekuivalent, dhe standartit ISEA 107 R 2 ose ekuivalent dhe standartit ISEA 107 P 2 ose ekuivalent dhe standartit NZS 4602 1 D/N ose ekuivalent dhe standartit NZS 1906.4 ose ekuivalent nuk është lëshuar nga laboratorë i akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, pasi laboratori që e ka lëshuar nuk është i akredituar për të kryer analizë lidhur me përmbushjen e standartit ISO 20471 ose ekuivalent, dhe standartit ISEA 107 R 2 ose ekuivalent dhe standartit ISEA 107 P 2 ose ekuivalent dhe standartit NZS 4602 1 D/N ose ekuivalent dhe standartit NZS 1906.4 ose ekuivalent”, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në shtojcën 7 pika 2.4 të dokumenteve të tenderit të ndryshuar përcaktohet se “**2.4.Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (raporte testimi)** të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyrimit të njëjta).Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standardi EN ose ekuivalente duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara sipas rregullores EU nr 425/2016, ose ekuivalente”. Në shtojcën 5 “Specifikimet Teknike”, të dokumenteve të tenderit të modifikuar për artikullin jelek fosforeshent përcaktohet se : “Jeleku duhet te jete me thurrje te perdhredhura dhe materiali duhet te jete 100% poliester. Jeleku duhet te kete aftesi dukshmerie shume te larta, duhet te kete ngjyre portokalli ne

perputhje me standardin ISO 20471 ose ekuivalent. Jeleku duhet te jete I lehte ne menyre te tille qe mos te krijoje pengesa gjate punimit, mbyllja duhet te behet me ane te materialit "Velcro" ose ekuivalent dhe duhet te jete I certifikuar per te rezistuar mbi 45 larje. Jeleku nuk duhet te kete me pak se dy shirita reflektues vertikal dhe dy shirita reflektues horizontal ne menyre te tille qe te sigurohet dukshmeri e plote. Prerja e jelekut duhet te jete e tille qe te siguroje nje komfort total te operatorit. Jeleku duhet te kete te stampuar ne anen e majte stemen e "Ujesjelles Kanalizime Tirane UKT sh.a" dhe gjithashtu ne gjithe pjesen e pasme te tij. Jeleku duhet te jete I modeluar ne perputhje me standardet ISEA 107 R 2; ISEA 107 P 2; NZS 4602.1 D/N; NZS 1906.4 ose ekuivalent te tyre", Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se në përmbushje të kriterit operatori ekonomik "Vojsava Zenelaj" PF ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektornik ofertën teknike, ku ka përcaktuar emërtimin e produktit, kompaninë prodhuese, emërtimin e katalogut, referenca në katalog/kod produktit ose nr. i faqes në katalog, si dhe shënime. Gjithashtu, operatori ekonomik "Vojsava Zenelaj" PF ka ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik raport - testimi të realizuar nga laboratorit Fiziko Mekanik dhe kimik i tekstilit dhe lëkurës (Universiteti Politeknik i Tiranës), akredituar nga Drejtoria e Akreditimit, sipas S SH ISO/IEC 71025:2017. Konkretisht operatori ekonomik "Vojsava Zenelaj" Pf ka dorëzuar raporte testimi nr. A2-60, nr. A2-59, nr. A2-61, nr. A2-62, nr. A2-63, nr. A2-64, nr. A2-65, nr. A2-66, nr. A2- 67, nr. A2-68, nr. A2-69, nr. A2-55, nr. A2-54, nr. L2-13, **nr. A2-56**, nr. A2-58, nr. A2-57, nr. A2-70, nr. A2-71, nr. A2-72, nr. A2-73, nr. A2-74, nr. L2-14, si dhe katalogun ISMONT të përkthyer dhe noterizuar. Referuar pikës 2.4 të shtojcës 7, kriteret e veçanta të kualifikimit të modifikuar, autoriteti kontraktor ka kërkuar **2.4.Dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare (raporte testimi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta).**Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti EN ose ekuivalente duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara sipas rregullores EU nr 425/2016, ose ekuivalente., Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor ka kërkuar raporte testimi të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare.

Në kuadër të shqyrtimit administrativ të ankesës, në mënyrë sa më transparente dhe të drejtë Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se për sqarimin e fakteve kërkohen verifikime të posaçme pranë organeve kompetente si Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, si institucioni i vetëm publik, i cili në bazë të ligjit nr 116 datë 11.09.2014 "Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë" në nenin 4 të tij thuhet, se "Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit është i vetmi organizëm kombëtar që kryen akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit". Nga verifikimi në ueb-in <http://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>, kryer në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, Komisioni konstaton, se laboratorit Fiziko Mekanik dhe kimik i tekstilit dhe lëkurës (Universiteti Politeknik i Tiranës) rezulton, që është laborator i akredituar nga drejtoria e përgjithshme e akreditimit për analizat kimike të lëkurës, fibrave dhe tekstilit.

Për rrjedhojë operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF me raport testimet e dorëzuara, përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, për dorëzimin e raport testeve të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare/ndërkombëtare.

Akoma më tej, referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues “Malbertex” SHPK me arsyetimin, se *“Gjithashtu, dëshmia e testimit zyrtar ose raporti i testimit i paraqitur nga ky konkurent për artikullin jelek fosforeshent nuk vërteton përmbushjen e standartit ISO 20471 ose ekuivalent, dhe standartit ISEA 107 R 2 ose ekuivalent dhe standartit ISEA 107 P 2 ose ekuivalent dhe standartit NZS 4602 1 D/N ose ekuivalent dhe standartit NZS 1906.4 ose ekuivalent nuk është lëshuar nga laboratorë i akredituar sipas standardeve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi që vërtetojnë [...]”*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, ISO e kërkuar nga autoriteti kontraktor në shtojcën 5 *“specifikimet teknike”* për secilin prej artikujve, konkretisht *“Jeleku duhet të jete I modeluar ne perputhje me standardet ISEA 107 R 2; ISEA 107 P 2; NZS 4602.1 D/N; NZS 1906.4 ose ekuivalent te tyre.”*, nuk është për metoda prove, dhe se laboratori nuk teston mbi standardet e vendosura nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike, por teston mbi standardet për të cilat është akredituar. Konkretisht për sa i përket standardeve *ISEA 107 R 2; ISEA 107 P 2; NZS 4602.1 D/N; NZS 1906.4 ose ekuivalent te tyre* është një informacion që duhet të jepet nga prodhuesi dhe nuk i referohet standartit për të cilin laboratori duhet të jetë i akredituar.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “Malbertex” SHPK nuk qëndron.

III.5 Lidhur me pretendimin për skualifikimin e operatorit ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF me arsyetimin se: *“Dëshmia e testimit zyrtar ose raport i testimit i paraqitur nga ky konkurent për artikullin kominoshe pune kundra ujit nuk vërteton përmbushjen e standartit ISO 24232 ose ekuivalent, pasi dëshmia e testimit zyrtar ose raporti i testimit nuk është lëshuar për kompaninë prodhuese dhe për emërtimin e produktit dhe për kodin e produktit të deklaruar nga ana e këtij konkurenti në ofertën teknike. Gjithashtu dëshmia e testimit zyrtar ose raporti i testimit i paraqitur nga ky konkurent për artikullin kominoshe pune kundra ujit për a i përket përmbushjes së standartit ISO 24232 ose ekuivalent nuk është lëshuar nga laboratorë i akredituar sipas standardeve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, pasi laboratori që e ka lëshuar nuk është i akredituar për të kryer analizë lidhur me përmbushjen e standartit ISO 24232 ose ekuivalent”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren,

III.5.1 Në shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë:

Ne kriteret e vecanta te kualifikimit perkatesisht ne piken 2.4 eshte kerkuar si me poshte vijon:

Ishte :

2.4.Dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare (raporte testi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

(Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta).Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti EN ose ekuivalente duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara me rregulloren EU nr 425/2016, ose ekuivalente.

Behet:

2.4.*Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (raporte testimi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta).Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti EN ose ekuivalente duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara sipas rregulloreve EU nr 425/2016, ose ekuivalente.*

III.5.2 Në shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit, shtojca 5 "Specifikimet teknike", është modifikuar si më poshtë vijon:

1. Kominoshe pune kundra ujit.

Kominoshet duhet të ofrojnë mbrojtje të plote në çdo situatë të vështirë atmosferike, duhet të jenë material poliestër 100% dhe duhet të jenë të veshura me një shtresë PVC. Seti duhet të përfshijë pjesën e poshtme të pantallonave dhe pjesën e sipërme në formë xhakete. Xhaketa duhet të jetë me të pakten dy xhepa në pjesën e përparme, një kapuc dhe me mundësi për ajrosje dhe ventilim në pjesën e pasme. Në pjesën e përparme duhet të jetë e pajisur me zinxhir në mënyrë që të krijojë lehtësi gjatë veshjes. Menget e xhaketes duhet të kenë në pjesën e brendshme pjesë elastike në mënyrë që të jetë e izoluar plotësisht nga penetrimi I ujit. Pantallonat duhet të jenë të pajisura me jo me pak se dy xhepa në pjesën anësore të këmbeve dhe duhet të kenë pjesën e belit plotësisht elastike për të krijuar lehtësi për t'u veshur dhe komoditet gjatë punimit. Qepjet e xhaketes dhe të pantallonave duhet të jenë të izoluar për të ndaluar futjen e ujit. Kominoshet duhet të jenë të prodhuara në përputhje të plote me standardin ISO 24232 ose ekuivalent. Gjatesia e pantallonave duhet të jetë midis diapazonit 106 – 115 cm ndërsa gjatesia e xhaketes duhet të jetë jo me pak se 74 cm dhe jo me shumë se 85 cm. Masat e setit duhet të ofrohen nga madhësia S deri në XXXL.

III.5.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik "Vojsava zenelaj" SHPK, për përmbushjen e kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Dokumentin pdf të emërtuar 2.3_Oferta_teknike
- Dokumentin pdf të emërtuar 2.4_Raporte_testimi
- Dokumentin pdf të emërtuar 2.8_KATALOG_ISMONT
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_e_jelek_H110

- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_jelek_portokall
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_e_jelek_H100_H110+
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_e_kominosheve
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_e_setit_xhaketë_kundra_shiut_ff
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_CERTIFIKATE_JELEK_h130_H130+

III.5.4 Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative,

reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Akoma më tej, referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues “Malbertex” SHPK me arsyetimin se *dëshmia e testimi zyrtar ose raporti i testimi i paraqitur nga ky konkurent për artikullin mushama shiu përta i përket përmbushjes së standardit EN 388 ose ekuivalent nuk është lëshuar nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, pasi laborator i që e ka lëshuar nuk është i akredituar për të kryer analizë lidhur me përmbushjen e standardit EN 388 ose ekuivalent[...]*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ISO e kërkuar nga autoriteti kontraktor në shtojcën 5 “specifikimet teknike” për secilin prej artikujve, konkretisht për artikullin mushama shiu, se *cdo parameter i mushamase duhet të jete sipas standardit EN 343 ose ekuivalent. Mushamaja duhet të ofrohet në madhësi S deri në 4XL*, Komisioni gjykon se standardi i kërkuar EN 343 nuk është për metoda prove, dhe se laborator i nuk teston mbi standardet e vendosura nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike, por teston mbi standardet për të cilat është akredituar. Konkretisht standardi i kërkuar EN 343, nuk i referohet standardit për të cilin laborator i duhet të jetë i akredituar.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “Malbertex” SHPK nuk qëndron.

III.8 Lidhur me pretendimin për skualifikimin e operatorit ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF me arsyetimin se: *“Dëshmia e testimi zyrtar ose raport i testimi i paraqitur nga ky konkurent për artikullin jelek dimri nuk vërteton përmbushjen e standardit SSH/EN ISO 20471, pasi dëshmia e testimi zyrtar ose raporti i testimi nuk është lëshuar për kompaninë prodhuese dhe për emërtimin e produktit dhe për kodin e produktit të deklaruar nga ana e këtij konkurenti në ofertën teknike. Gjithashtu dëshmia e testimi zyrtar ose raporti i testimi i paraqitur nga ky konkurent për artikullin jelek dimri përta i përket përmbushjes së standardit SSH/EN ISO*

20471 nuk është lëshuar nga laboratorë i akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specififikimet teknike, pasi laboratorit që e ka lëshuar nuk është i akredituar për të kryer analizë lidhur me përmbushjen e standartit SSH/EN ISO 20471”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.8.1 Në shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë:

*Ne kriteret e vecanta te kualifikimit perkatesisht ne piken 2.4 eshte kerkuar si me poshte vijon:
Ishte :*

2.4.Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (raporte testimi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specififikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta).Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti EN ose ekuivalente duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara me rregulloren EU nr 425/2016, ose ekuivalente.

Behet:

2.4.Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (raporte testimi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specififikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta).Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti EN ose ekuivalente duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara sipas rregullore EU nr 425/2016, ose ekuivalente.

III.8.2 Në shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit, shtojca 5 ”Specifikimet teknike”, është modifikuar si më poshtë vijon:

1. Jelek dimri

Të ofrojë cilësi dhe fleksibilitet i lartë me më shumë ngrohtësi, dy xhepa portokalli fosforeshent portokalli të thellë në të dyja anët dhe shiritar eflektues ngjyrë gri.

Veçoritë

Pëlhurë e fortë poliester/pambuk Shirit reflektues për më shumë dukshmëri

Xhepa përpara

Me Shtresë dhe mbushje të plotë për të mbajtur ngrohtësinë e trupit

pëlhurë e klasifikuar me UPF 40+ për të bllokuar 98% rrezeve UV

Shtresë e sipërfaqësore Anti Vaj, Anti Uje dhe Anti Njolle

Certifikim SSH/CE

Certifikuar sipas SSH/EN ISO 20471 pas larjes 25

Përputhet me standartin SSH/EN ISO 20471

Materialet:

Pëlhura Jashtme/Kryesore: 80% Poliestër, 20% Pambuk 280g

Materiali Shtrese: 100% Poliestër, 200g

Astari: 65% Poliestër, 35% Pambuk, 260g

STANDARTET

SSH/EN ISO 20471 Klasi 2

III.8.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Vojsava zenelaj” PF, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Dokumentin pdf të emërtuar 2.3_Oferta_teknike
- Dokumentin pdf të emërtuar 2.4_Raporte_testimi
- Dokumentin pdf të emërtuar 2.8_KATALOG_ISMONT
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_e_jelek_H110
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_jelek_portokall
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_e_jelek_H100_H110+
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_e_kominosheve
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_e_setit_xhaketë_kundra_shiut_ff
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_CERTIFIKATE_JELEK_h130_H130+

III.8.4. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë

nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.8.5. Në rastin konkret, referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues “Malbertex” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF, me arsyetimin se: “Dëshmia e testimi zyrtar ose raport i testimi i paraqitur nga ky konkurent për artikullin jelek dimri nuk vërteton përmbushjen e standartit SSH/EN ISO 20471, pasi dëshmia e testimi zyrtar ose raporti i testimi nuk është lëshuar për kompaninë prodhuese dhe për emërtimin e produktit dhe për kodin e produktit të deklaruar nga ana e këtij konkurenti në ofertën teknike. Gjithashtu dëshmia e testimi zyrtar ose raporti i testimi i paraqitur nga ky konkurent për artikullin jelek dimri përa i përket përmbushjes së standartit SSH/EN ISO 20471 nuk është lëshuar nga laboratorë i akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, pasi laboratorit që e ka lëshuar nuk është i akredituar për të kryer analizë lidhur me përmbushjen e standartit SSH/EN ISO 20471...”, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se në shtojcën 7 pika 2.4 përcaktohet se “**2.4. Dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare (raporte testi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta).**Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti EN ose ekuivalente duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara sipas rregullores EU nr 425/2016, ose ekuivalente”. Në shtojcën 5 specifikimet teknike për artikullin jelek dimri, përcaktohet se:

“Të ofrojë cilësi dhe fleksibilitet i lartë me më shumë ngrohtësi, dy xhepa portokalli fosforeshent portokalli të thellë në të dyja anët dhe shiritar eflektues ngjyrë gri.

Veçoritë

Pëlhurë e fortë poliestër/pambuk Shirit reflektues për më shumë dukshmëri, Xhepa përpara Me Shtresë dhe mbushje të plotë për të mbajtur ngrohtësinë e trupit, pëlhurë e klasifikuar me UPF 40+ për të bllokuar 98% rrezeve UV, Shtresë e sipërfaqësore Anti Vaj, Anti Uje dhe Anti Njolle, Certifikim SSH/CE, Certifikuar sipas SSH/EN ISO 20471 pas larjes 25, Përputhet me standartin SSH/EN ISO 20471

Materialet:

Pëlhura Jashtme/Kryesore: 80% Poliestër, 20% Pambuk 280g

Materiali Shtrese: 100% Poliestër, 200g

Astari: 65% Poliestër, 35% Pambuk, 260g

STANDARTET

SSH/EN ISO 20471 Klasi 2”, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se në përmbushje të kriterit operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektornik ofertën teknike, ku ka përcaktuar emërtimin e produktit, kompaninë prodhuese, emërtimin e katalogut, referenca në katalog/kod produktit ose nr. i faqes në katalog, si dhe shënime. Gjithashtu, operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF ka ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik raport - testimi të realizuar nga laboratorit Fiziko Mekanik dhe Kimik i Tekstilëve dhe Lëkurës (Universiteti Politeknik i Tiranës), akredituar nga Drejtoria e Akreditimit, sipas S SH ISO/IEC 71025:2017. Konkretisht operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” Pf ka dorëzuar raporte testimi nr. A2-60, nr. A2-59, nr. A2-61, nr. A2-62, nr. A2-63, nr. A2-64, **nr. A2-65**, nr. A2-66, nr. A2- 67, nr. A2-68, nr. A2-69, nr. A2-55, nr. A2-54, nr. L2-13, A2-56, A2-58, A2-57, nr. A2-70, nr. A2-71, nr. A2-72, nr. A2-73, nr. A2-74, nr. L2-14, si dhe katalogun ISMONT të përkthyer dhe noterizuar. Referuar pikës 2.4 të shtojcës 7 kriteret e veçanta të kualifikimit të modifikuar, autoriteti kontraktor ka kërkuar **2.4.Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (raporte testimi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta).**Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti EN ose ekuivalente duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara sipas rregullores EU nr 425/2016, ose ekuivalente., Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor ka kërkuar raporte testimi të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare/ndërkombëtare.

Në kuadër të shqyrtimit administrativ të ankesës, në mënyrë sa më transparente dhe të drejtë, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se për sqarimin e fakteve kërkohen verifikime të posaçme pranë organeve kompetente si Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, si institucioni i vetëm publik, i cili në bazë të ligjit nr. 116, datë 11.09.2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 4 të tij, thuhet se: “Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit është i vetmi organizëm kombëtar që kryen akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit”. Nga verifikimi në ueb-in [56](http://dpa.gov.al/organe-te-</p></div><div data-bbox=)

[akredituara/](#), kryer në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, Komisioni konstaton, se laborator i Fiziko Mekanik dhe Kimik i Tekstilit dhe Lëkurës (Universiteti Politeknik i Tiranës) rezulton, që është laborator i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për analizat kimike të lëkurës, fibrave dhe tekstilit.

Për rrjedhojë, operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF, me raport testimet e dorëzuara përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, për dorëzimin e raport testeve të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare/ndërkombëtare.

Akoma më tej, referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues “Malbertex” SHPK me arsyetimin se “*...për artikullin jelek dimri përta i përket përmbushjes së standardit SSH/EN ISO 20471 nuk është lëshuar nga laboratorë i akredituar sipas standardeve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specififikimet teknike, pasi laborator që e ka lëshuar nuk është i akredituar për të kryer analizë lidhur me përmbushjen e standardit SSH/EN ISO 20471t. [...]*”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ISO e kërkuar nga autoriteti kontraktor në shtojcën 5 “specifikimet teknike” për secilin prej artikujve, konkretisht për artikullin jelek dimri, se duhet të përputhet me standardin SSH/EN ISO 20471, ky standard i kërkuar SSH/EN ISO 20471 nuk është për metoda prove, dhe se laborator nuk teston mbi standardet e vendosura nga autoriteti kontraktor në specififikimet teknike, por teston mbi standardet për të cilat është akredituar. Konkretisht standardi i kërkuar SSH/EN ISO 20471, nuk i referohet standardit për të cilin laborator duhet të jetë i akredituar.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “Malbertex” SHPK nuk qëndron.

III.9 Lidhur me pretendimin për skualifikimin e operatorit ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF me arsyetimin se: “*Dëshmia e testimit zyrtar ose raport i testimit i paraqitur nga ky konkurent për artikullin këpucë kundër rrymës elektrike nuk vërteton përmbushjen e standardit SSH/EN ISO 20347, pasi dëshmia e testimit zyrtar ose raporti i testimit nuk është lëshuar për kompaninë prodhuese dhe për emërtimin e produktit dhe për kodin e produktit të deklaruar nga ana e këtij konkurenti në ofertën teknike. Gjithashtu dëshmia e testimit zyrtar ose raporti i testimit i paraqitur nga ky konkurent për artikullin këpucë kundër rrymës elektrike përta i përket përmbushjes së standardit SSH/EN ISO 20347 nuk është lëshuar nga laboratorë i akredituar sipas standardeve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specififikimet teknike, pasi laborator që e ka lëshuar nuk është i akredituar për të kryer analizë lidhur me përmbushjen e standardit SSH/EN ISO 20347*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.9.1 Në shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë:

*Ne kriteret e vecanta te kualifikimit perkatesisht ne piken 2.4 eshte kerkuar si me poshte vijon:
Ishte :*

2.4.Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (raporte testimi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta).Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti EN ose ekuivalente duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara me rregulloren EU nr 425/2016, ose ekuivalente.

Behet:

2.4.Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (raporte testimi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta).Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti EN ose ekuivalente duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara sipas rregulloreve EU nr 425/2016, ose ekuivalente.

III.9.2 Në shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit, shtojca 5 "Specifikimet teknike", është modifikuar si më poshtë vijon:

Këpuçë pune, prodhuar nga lëkurë ngjyrë e zezë, antistatike, shuall me densitet të dyfishtë, jo të pajisura me shtresa metalike, majë mbrojtëse për gishtat.

Këpuçët profesionale duhet të jenë prodhuar në përputhje me standartin e sigurisë në punë SSH/EN ISO 20347 ose ekuivalent.

Referuar standartit të mësipërm, këpuca duhet të plotësojë specifikimet bazike si mëposhtë vijon: *Këpuce antistatike*

- Mbrojtësja e gishtave komposite per nje mbrojte maksimale*
- Sholle e mesme Anti-Shpim Komposite*
- Sistem të absorbimit të energjisë*
- Membrane 100% Ujedaluese*
- Sholle Anti-Rreshkitje (SRC)*
- Rezistente ndaj nxehtësisë*
- Sholle rezistente ndaj vajrave*
- Shuall me densitet te dyfishte*
- 100% jo metalike*

III.9.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik "Vojsava zenelaj" SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Dokumentin pdf të emërtuar 2.3_Oferta_teknike
- Dokumentin pdf të emërtuar 2.4_Raporte_testimi
- Dokumentin pdf të emërtuar 2.8_KATALOG_ISMONT
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_e_jelek_H110
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_jelek_portokall
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_e_jelek_H100_H110+
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_e_kominosheve
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_certifikate_e_setit_xhaketë_kundra_shiut_ff
- Dokumentin pdf të emërtuar EUEN_CERTIFIKATE_JELEK_h130_H130+

III.9.4. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi

të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.9.5. Në rastin konkret, referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues “Malbertex” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Vojsava Zenelaj” SHPK me arsyetimin se “Dëshmia e testimi zyrtar ose raport i testimi i paraqitur nga ky konkurent për artikullin këpucë kundër rrymës elektrike nuk vërteton përmbushjen e standartit SSH/EN ISO 20347, pasi dëshmia e testimi zyrtar ose raporti i testimi nuk është lëshuar për kompaninë prodhuese dhe për emërtimin e produktit dhe për kodin e produktit të deklaruar nga ana e këtij konkurenti në ofertën teknike. Gjithashtu dëshmia e testimi zyrtar ose raporti i testimi i paraqitur nga ky konkurent për artikullin këpucë kundër rrymës elektrike përa i përket përmbushjes së standardit SSH/EN ISO 20347 nuk është lëshuar nga laboratorë i akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, pasi laboratorit që e ka lëshuar nuk është i akredituar për të kryer analizë lidhur me përmbushjen e standartit SSH/EN ISO 20347”, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se në shtojcën 7 pika 2.4, përcaktohet se **2.4.Dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare (raporte testi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta).**Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standardi EN ose ekuivalente duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara sipas rregullores EU nr 425/2016, ose ekuivalente. Në shtojcën 5, specifikimet teknike për artikullin pantallona pune, përcaktohet se: “ Këpucë pune, prodhuar nga lëkurë ngjyrë e zezë, antistatike, shuall me densitet të dyfishtë, jo të pajisura me shtresa metalike, majë mbrojtëse për gishtat.

Këpucët profesionale duhet të jenë prodhuar në përputhje me standardin e sigurisë në punë SSH/EN ISO 20347 ose ekuivalent.

Referuar standartit të mësipërm, këpuca duhet të plotësojë specifikimet bazike si mëposhtë vijon: Kepuce antistatike

- Mbrojtësja e gishtave komposite per nje mbrojte maksimale
- Sholle e mesme Anti-Shpim Komposite
- Sistem të absorbimit të energjisë
- Membrane 100% Ujedaluese

- *Sholle Anti-Rreshkitje (SRC)*
- *Rezistente ndaj nxehtësisë*
- *Sholle rezistente ndaj vajrave*
- *Shuall me densitet te dyfishte*

□ *100% jo metalike*". Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se në përmbushje të kriterit, operatori ekonomik "Vojsava Zenelaj" SHPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektornik ofertën teknike, ku ka përcaktuar emërtimin e produktit, kompaninë prodhuese, emërtimin e katalogut, referenca në katalog/kod produktit ose nr. i faqes në katalog, si dhe shënime. Gjithashtu, operatori ekonomik "Vojsava Zenelaj" PF ka ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik, raport - testimi të realizuar nga laboratorit Fiziko Mekanik dhe kimik i tekstilit dhe lëkurës (Universiteti Politeknik i Tiranës), akredituar nga Drejtoria e Akreditimit, sipas S SH ISO/IEC 71025:2017. Konkretisht, operatori ekonomik "Vojsava Zenelaj" Pf ka dorëzuar raporte testimi nr. A2-60, nr. A2-59, nr. A2-61, nr. A2-62, nr. A2-63, nr. A2-64, nr. A2-65, nr. A2-66, nr. A2-67, nr. A2-68, nr. A2-69, nr. A2-55, nr. A2-54, nr. L2-13, A2-56, A2-58, A2-57, nr. A2-70, nr. A2-71, nr. A2-72, nr. A2-73, nr. A2-74, **nr. L2-14**, si dhe katalogun ISMONT të përkthyer dhe noterizuar. Referuar pikës 2.4 të shtojcës 7, kriteret e veçanta të kualifikimit të modifikuar, autoriteti kontraktor ka kërkuar **2.4.Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (raporte testimi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specififikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta).Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti EN ose ekuivalente duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara sipas rregullores EU nr 425/2016, ose ekuivalente.** Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor ka kërkuar raporte testimi të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare/ndërkombëtare.

Në kuadër të shqyrtimit administrativ të ankesës, në mënyrë sa më transparente dhe të drejtë, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se për sqarimin e fakteve kërkohen verifikime të posaçme pranë organeve kompetente, si Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, si institucioni i vetëm publik, i cili në bazë të ligjit nr. 116, datë 11.09.2014, "Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë", në nenin 4 të tij thuhet, se "*Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit është i vetmi organizëm kombëtar që kryen akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit*". Nga verifikimi në ueb-in <http://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>, kryer në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, Komisioni konstaton, se Laboratori Fiziko Mekanik dhe Kimik i Tekstilit dhe Lëkurës (Universiteti Politeknik i Tiranës) rezulton, që është laborator i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për analizat kimike të lëkurës, fibrave dhe tekstilit.

Për rrjedhojë, operatori ekonomik "Vojsava Zenelaj" PF, me raport testimet e dorëzuara, përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, për dorëzimin e raport – testimeve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare/ndërkombëtare.

Akoma më tej, referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues “Malbertex” SHPK, me arsyetimin, se *Gjithashtu dëshmia e testimi zyrtar ose raporti i testimi i paraqitur nga ky konkurent për artikullin këpucë kundër rrymës elektrike përa i përket përmbushjes së standardit SSH/EN ISO 20347 nuk është lëshuar nga laboratorë i akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, pasi laboratorit që e ka lëshuar nuk është i akredituar për të kryer analizë lidhur me përmbushjen e standartit SSH/EN ISO 20347.....* Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ISO e kërkuar nga autoriteti kontraktor në shtojcën 5 “specifikimet teknike” për secilin prej artikujve, konkretisht për artikullin këpucë pune, këpucët profesionale duhet të jenë prodhuar në përputhje me standardin e sigurisë në punë SSH/EN ISO 20347 ose ekuivalent”, nuk është për metoda prove, dhe se laboratorit nuk teston mbi standardet e vendosura nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike, por teston mbi standardet për të cilat është akredituar. Konkretisht standardi *SSH/EN ISO 20347*, është një informacion që nuk i referohet standardit për të cilin laboratorit duhet të jetë i akredituar, por një standard që tregon përmbushjen e specifikimeve teknike të caktuara të këtij artikulli.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “Malbertex” SHPK nuk qëndron.

III.10. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Malbertex” SHPK, për shtimin e arsyeve të skualifikimit të operatorit ekonomik “Blerina Sadiku” PF, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ky operator ekonomik rezulton i skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi që me vendimin e KVO-së të datës 19.03.2024, dhe nuk ka paraqitur asnjë ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Për rrjedhojë, gjendja e tij faktike dhe juridike është e skualifikuar, pa asnjë ndikim në interesat e ankimuesit. Sa më sipër, për sa kohë gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Blerina Sadiku” PF është e skualifikuar, rrjedhimisht pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për shtimin e arsyeve të skualifikimit, nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.11 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Vojsava Zenelaj” pf për skualifikimin e operatorit ekonomik “Malbertex” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë gjendja juridike dhe faktike e operatorit ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF nuk do të ndryshojë, duke mbetur i kualifikuar, duke përmbushur kështu interesin e tij të ligjshëm për të fituar kontratën objekt – prokurimi, nuk do të merren në shqyrtim nga Komisioni Prokurimit Publik në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë

prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “*Malbertex*” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshuar*”, me Nr. REF-92495-12-29-2023, me objekt: Blerje veshje të ndryshme pune për UKT SH.A”, me fond limit 9,999,829.00 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 31.01.2024, nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.
 2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “*Vojsava Zenelaj*” PF, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshuar*”, me Nr. REF-92495-12-29-2023, me objekt: Blerje veshje të ndryshme pune për UKT SH.A”, me fond limit 9,999,829.00 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 31.01.2024, nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.
 3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, sipas legjislacionit të prokurimit publik.
 4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Malbertex*” SHPK, si dhe për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Vojsava Zenelaj*” PF.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri

